



MJEDISI SI MEDIUM PËR PROMOVIMIN E DEMOKRACISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHOQËRIVE NË TRANZICION

Raporti nga Konferenca Rajonale
Parlamentare për Mjedisin në Evropën
Juglindore





MJEDISI SI MEDIUM PËR PROMOVIMIN E DEMOKRACISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHOQËRIVE NË TRANZICION

Raporti nga Konferenca Rajonale
Parlamentare për Mjedisin në Evropën
Juglindore

18 – 21 tetor, 2007
Prishtinë

PARATHËNIE... 5

REZULTATET KRYESORE NGA KONFERENCA
RAJONALE PARLAMENTARE PËR MJEDISIN... 6-11

SHTOJCA NJË:

VËREJTJET HYRËSE... 12-14

RAPORTET E SEANCËS... 15-30

LISTA E PJESËMARRËSVE... 31-32




Raporti i përgatitur nga:
Blerim Vela

Raportuesit:
Lejla Selimi
Petrit Hysaj
Konstantin Barwaldt

Fotot:
Hasan Sopa

Disenji:
Edi Agagjyshi

© Misioni i OSBE-së në Kosovë

Prishtinë 2008

PARATHËNIE

Prishtinë, janar 2008

Gjatë tridhjetë viteve të fundit Evropa është shqetësuar lidhur me gjendjen e mjedisit dhe u bë shumë e vendosur për të reduktuar dëmet, duke bërë shmangie të mundshme. Një valë e brengosjes për mjedisin ka filluar në kohërat e prosperimit. Me dobësimin e ekonomive dhe me rritjen e shkallës së papunësisë, ra edhe interesimi. Kjo nuk duhet ta befasojë askënd. Në kohëra të vështira njerëzit më së shumti brengosen për punën e tyre, shtëpitë e tyre dhe se a do të jenë në gjendje për të ushqyer familjen e tyre. Vetëm kur ata kanë siguri ekonomike ata janë në gjendje të relaksohet sa duhet për të përqendruar vëmendjen e tyre në çështje tjera.

Më 19 dhe 20 tetor 2007, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës organizuan konferencën parlamentare rajonale për Evropën Juglindore lidhur me mjedisin "Mjedisi si Medium për Demokraci dhe Zhvillimin Ekonomik të Shoqërive në Tranzicion". Më tepër se tridhjetë deputetë nga parlamentet e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Kosovës dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë morën pjesë në konferencë. Synimi i kësaj konference ishte që të diskutohen zhvillimet tejkufitare mjedisore dhe roli i parlamenteve në mbikëqyrjen e politikbërjes lidhur me mjedisin dhe implementimin e saj. Konferencat e mëhershme, si dy konferencat rajonale parlamentare për mbikëqyrjen e sigurisë të organizuara nga OSBE-ja në Mitrovicë/Mitrovica në qershor të vitit 2006 dhe në Prishtinë/Priština në maj të vitit 2007, janë dëshmuar si instrumente efektive për zhvillimin e rrjeteve parlamentare rajonale dhe bashkëpunimin në përgatitjen e procesit të integritimit evropian.

Kjo konferencë vuri në pah sfidat e përbashkëta të shoqërive në rajon për implementimin e efektshëm të politikave mjedisore. Është e qartë se të gjitha strategjitë për mbrojtjen e mjedisit bëjnë thirrje për zvogëlim të ndotjes, ndonëse arritja e ndonjë përmirësimi të dukshëm nënkupton, që politikanët dhe publiku duhet të adresojnë çështjet ekonomike të ngritura nga kontrolli i ndotjes. Në një ekonomi të tregut, mallrat dhe shërbimet prodhohen si përgjigje ndaj kërkesës së konsumatorëve, e cila në shumicën e rasteve është e ndjeshme ndaj çmimit. Veç kësaj, debati mjedisor ka zbuluar se është vështirë të matet ndikimi i saktë i ndotjes, pasi që ndotja mund të dëmtojë shëndetin e disa njerëzve, gjë që do të kërkojë nga ata të kërkojnë trajtim mjekësor, i cili duhet të paguhet nga komuniteti i gjerë apo nga vetë individët varësisht nga sistemi i kujdesit mjekësor, përkundër kostos që ata e paguajnë për sa i përket vuajtjes. Pra, zvogëlimi i ndotjes bëhet në formë të kompromiseve në mes të ambientit të pastër të cilin e kërkon publiku, masës së përmirësimit të cilin industritë janë në gjendje ta arrijnë sa i përket teknologjisë dhe efektin e përgjithshëm të çmimeve dhe ekonomive kombëtare.

Gjatë kësaj konference dy ditore, deputetët nga rajoni diskutuan lidhur me çështjet e lartpërmendura dhe praktikën më të mira në qeverisjen mjedisore në nivelin nacional dhe tejkufitar. Ky diskutim iu siguroi ligjbërësve në rajon kuptimin e parimeve, institucioneve dhe mekanizmave pjesëmarrës të cilët kontribuojnë në përputhshmërinë me ligjet dhe standardet mjedisore. Konferenca iu drejtua këtyre çështjeve dhe nënvizoi praktikën më të mira, që do të përdoren në të ardhmen nga deputetët në Kosovë dhe rajon.

Përfundimisht, qëllimi i këtij publikimi është që të shërbejë si kujtesë institucionale për mandatin e ri të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës dhe të informojë publikun për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Ky raport përmban përmbledhje të diskutimeve si dhe konkluzioneve të konferencës për të vazhduar tutje.

Markku Laamanen
Zëvendës Kryesues i Misionit
Misioni i OSBE-së në Kosovë



Rezultatet kryesore të konferencës parlamentare rajonale për mjedisin

Kosova ka probleme të dukshme mjedisore si pasojë e emetuesve të mëdhenj industrial dhe përdorimit të pakontrolluar të pasurive natyrore dhe mineraleve gjatë disa dekadave të fundit. Kjo ka rezultuar në një mjedis të dëmtuar, në disa raste edhe të riparueshëm, i cili mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë negativ në shëndetin e popullatës. Në të njëjtën kohë Kosova është nën presion për të përmbushur standardet mjedisore të BE-së.¹

Kjo kërkon një bashkëpunim rajonal për të adresuar çështjet mjedisore tejkuftare.¹ Disa akterë janë përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, shumicës prej të cilëve iu mungon përvoja dhe njohu-



RUMEN TAKOROV, STANCHO TODOROV,
PETAR BERON DHE LIIA HANNI

ritë. Kjo është pjesërisht kështu për shkak se mbrojtja e mjedisit është fushë e re, në të cilën si akterët qeveritar ashtu edhe ata joqeveritar po bëhen aktiv çdo ditë e më shumë. Në një hulumtim të bërë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) në Kosovë në vitin 2006, është arritur në përfundim se organizatat mjedisore të shoqërisë civile janë ende të brishta.² Veç kësaj, organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Kosovë, e kanë shumë vështirë që të bashkëpunojnë me organizatat partnere jashtë Kosovës për shkak të mungesës së përvojës dhe mundësive të kufizuara për të konkurruar për fonde në nivel rajonal. Kjo situatë është e kuptueshme, pasi që këto organizata mjedisore të shoqërisë civile janë shumë të reja dhe shpesh nuk kanë personel pro-

fesional të mjaftueshëm me orar të plotë.

Akterët kryesor në fushën e mbrojtjes mjedisore, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe agjencitë e saj ekzekutive dhe Komisioni i Kuvendit të Kosovës për mjedis janë themeluar në vitin 2002. Deri më tani, ministria ka punuar shumë për të plotësuar zbrazëtirën ligjore, duke hartuar ligje (p.sh Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit) dhe legjisllacion sekondar (p.sh Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis) të bashkuara disa akte nënligjore të nënshkruara nga Ministri.

Ndonëse, ligjet për mjedisin janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi, implementimi i tyre nuk është i mjaftueshëm. Si rezultat i zbatimit të dobët, ligjet dhe politikat e mjedisit nuk i kanë arritur rezultatet e pritura. Kuvendi i Kosovës, e posaçërisht Komisioni i Kuvendit për Mjedisin nuk kanë kryer mbikëqyrje dhe monitorim të mjaftueshëm të implementimit të këtyre ligjeve.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka siguruar ndihmë për të ngritur kapacitetet e Komisionit të Kuvendit për Mjedisin për të mbikëqyruar punën e Ministrisë dhe implementimin e ligjeve. Mbështetja e OSBE-së u përqendrua në ngritjen e aftësive të anëtarëve të komisionit dhe personelit për të shqyrtuar legjisllacionin e propozuar, për të monitoruar implementimin e legjisllacionit të miratuar, për të kryer dëgjime hetimore dhe luajë rol aktiv në rrjetet rajonale. Kjo mbështetje ka siguruar një mundësi, në mënyrë që komisioni t'i vështrojë praktikën më të mira lidhur me qeverisjen mjedisore në shtetet në tranzicion me trashëgimi dhe praktika të ngjashme ekonomike dhe politike dhe të zhvillojë rrjete me komisionet për mjedis të kuvendeve nga shtetet në rajon për të adresuar ndotjen tejkuftare dhe për të zhvilluar iniciativa të reja për mjedisin.

Në mënyrë që të trajtohen sfidat specifike të qeverisjes në vend dhe jashtë kufijve dhe në mënyrë që të theksohet roli i parlamenteve në adresimin e kësaj çështjeje, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka organizuar një konferencë rajonale parlamentare.³ Synimi i kësaj konference ishte që të nxisë disku-

¹ Për shembull termocentralet e thëngjillit në Kosovë, të cilat po i ndotin ujërat e lumit Ibër dhe më pas Danubit dhe fabrika e çimentos në Hanin e Elezit e cila ndotë ajrin në vende kufitare të IRJ të Maqedonisë.

² REC (2006), "Zyra e kësaj OJQ-je për Evropën Juglindore – Rezultatet e zyrës dhe anketës për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor", botimi i pestë, Szentendre, f. 207-215.

³ Konferenca parlamentare për mjedisin në Evropën Juglindore "Mjedis si medium për Promovimin e Demokracisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Shoqëritë në Tranzicion" u mbajt në Prishtinë më 19-20 tetor, 2007.

time lidhur me zhvillimin dhe rolin e parlamenteve në mbikëqyrjen e politikave mjedisore dhe implementimit të tyre. Më tepër se tridhjetë deputetë të parlamenteve dhe kuvendeve nga Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë morën pjesë në këtë konferencë. Gjatë kësaj konference, deputetët si dhe ekspertët vendor e ndërkombëtar u pajtuan lidhur me rëndësinë e njohjes së përvojave nga vendet tjera dhe nxjerrjes së mësimave nga sukseset dhe gabimet e tyre.⁴ Kjo është posaçërisht relevante në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ku njohuritë lidhur me mjedisin, kërcënimet ndaj tij dhe metodat për mbrojtjen e vazhdueshme të tij evoluojnë me kohë.

Në bazë të konsultimeve dhe hulumtimeve të mëparshme, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës kanë zhvilluar një agjendë të konferencës e cila përmban katër sesione: qeverisja mjedisore, Konventa e Aarhusit, bashkëpunimi në çështjet mjedisore tejkufitare dhe korniza mjedisore e BE-së. Gjatë konferencës janë identifikuar disa tendenca të përbashkëta për tërë rajonin në përgjithësi:

- Administrimi mjedisor, siç ndodhë te çdo ekonomi në tranzicion, është relativisht i ulët në rajon. Mbrojtja mjedisore zakonisht nuk është prioritet politik dhe herë pas here qëndron përpara synimeve ambicioze ekonomike dhe infrastrukturore siç edhe u theksua nga përfaqësuesit e disa shteteve. Themelimi i administratës mjedisore në nivel min-

istror, autoritetet lokale dhe rajonale dhe organet tjera të ngjashme kërkojnë shumë kohë, përpjekje dhe burime financiare.

- Korniza ligjore për pushtetet dhe përgjegjësitë e qeverive lokale dhe qendrore është një sfidë tjetër për zhvillimin institucional në rajon.

- Në tërë rajonin, kompetencat ligjore në fushën e menaxhimit/mbrojtjes së ujërave janë të ndara në një numër ministrish (p.sh pesë ministri në rastin e IRJ të Maqedonisë), gjë që çon deri te përsëritja e punëve apo te kompetencat e paqarta. Disa shtete/entitete në Evropën Juglindore po bëjnë përpjekje të mëdha për të bashkuar përgjegjësitë për mbrojtjen e ujërave nëpër ministrinë e mjedisit. Komunitat dhe ndërmarrjet publike gjithashtu luajnë rolin e tyre në shumicën e çështjeve, që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave në nivel lokal, furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza.

- Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, komunitat janë përgjegjëse për implementimin e veprimtarive lidhur me mbeturinat e ekonomive familjare dhe komunale në pothuajse gjithë Evropën Juglindore. Komunitat janë gjithashtu përgjegjëse për implementimin e rregulloreve lokale. Në këtë rast, është e rëndësishme që të hartohen ato në nivel lokal, në një mënyrë homogjene dhe në përputhshmëri me legjislacionin në nivel nacional apo të entitetit.

- Veç kësaj, në shumicën e shteteve dhe entiteteve, procesi i ndërtimit institucional është i vazhdueshëm, me daljen e ministrive të reja apo krijimin e organeve dhe institucioneve të reja gjë që çon në kalimin dhe ndryshimin e kompetencave.



⁴Për më tepër informata lidhur me bashkëpunimin tejkufitar në fushën e qeverisjes së mjedisit, mund të shihni raportin e seancë për Qeverisje të Mjedisit në shtojcën 1.

Temat

Korniza Institucionale

Ndonëse të gjitha shtetet dhe rajonet të pranishme në konferencë përveç Shqipërisë dhe Bullgarisë, ishin shtete trashëguese të ish Jugosllavisë dhe strukturat e tyre institucionale dallojnë në mënyrë të konsiderueshme, gjë që pasqyrojnë zhvillimet politike të dekadës së fundit. Në përgjithësi, deputetët theksuan që kompetencat kryesore për çështjet mjedisore qëndron në nivelin shtetëror, por ekzistojnë edhe disa përjashtime.⁵ Në Bosnje dhe Hercegovinë për shembull, vetëm disa kompetenca mbahen në nivel shtetëror, përdërisa të dy kompetencat janë përgjegjëse për zhvillimin, implementimin dhe zbatimin e shumicës së legjislacionit për mjedisin. Ndërsa Republika Serbe (RS) e ndjek një qasje më të centralizuar, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (FBiH) cakton më shumë përgjegjësi nëpër kantone dhe komuna.⁶



SLAVICA JOSIPOVIĆ

Administrimi i mjedisit, siç është gjithnjë rasti me ekonominë në tranzicion, është relativisht i dobët në Evropën Juglindore. Siç është theksuar nga disa shtete, mbrojtja e mjedisit zakonisht nuk është prioritet politik dhe herë pas here qëndron në rrugë të synimeve ambicioze. Themelimi i administratës mjedisore në ministri, autoritete rajonale apo lokale dhe organe tjera të ngjashme kërkon mjaftë kohë, përpjekje dhe burime financiare.

Legjislacioni për mjedisin

Që nga viti 2003, të gjitha shtetet dhe rajonet e Evropës Juglindore kanë miratuar një numër bu-

kur të madh të ligjeve të reja për mjedisin, kanë riorganizuar institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe kanë hartuar plan-programe të reja të politikave. Pothuajse të gjitha shtetet dhe subjektet e Evropës Juglindore kanë hartuar ligje të reja kornizë për mjedisin që mund të shërbejnë si bazë ligjore për legjislacionin e mëtejshëm. Legjislacioni i ri duhet të reflektojë në të drejtën vendore në mënyrë që ajo të jetë e qëndrueshme, duke vazhduar edhe procesin e përafrimit dhe aderimit në Bashkimin Evropian. Prandaj të gjitha shtetet e Evropës juglindore kanë hartuar strategji dhe plane për mjedisin dhe kanë vendosur prioritete për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.

Anëtarët e parlamentit nga rajoni si dhe Qendra Rajonale Mjedisore theksuan rëndësinë e plotësimit të zbrazëtirës në legjislacionin mjedisor nga legjislacioni i zhvilluar plotësisht horizontal i mjedisit.⁷ Në mënyrë më specifike, kjo mund të bëhet nga legjislacioni mjedisor gjithëpërfshirës në vend të rregulloreve, të cilat aplikohen vlejshëm për një sektor specifik siç është uji apo ajri. Në vend të rregullimit të një fushe specifike, ky lloj i legjislacionit është më tepër procedural – dhe siguron metoda dhe mekanizma që synojnë përmirësimin e vendimmarrjes, zhvillimin legjislativ dhe zbatimin.

Fushat në vijim u kuptuan si horizontale: vlerësimi i ndikimit në ambient (VNA); vlerësimi strategjik mjedisor (VSM); qasja në informata për mjedisin; pjesëmarrja e publikut (në procesin vendimarrës dhe në planet dhe programet); dhe përgjegjësi për mjedisin.

Përafrimi me BE-në

Bashkimi Evropian i jep prioritet të lartë mbrojtjes së ambientit. Miratimi i legjislacionit mjedisor i cili është i harmonizuar me normat dhe juridike dhe standardet Evropiane konsiderohet si gurë themel në trasimin e rrugës drejt BE-së. Çështjet mjedisore u njohën si faktor motivues dhe si bllok ndërtues për bashkëpunim tejkuftar dhe zvogëlimin e konflikteve.

⁵ Për më tepër informata për kornizën institucionale në fushën e mjedisit, ju lutem shihni raportin e seancës për Qeverisjen Mjedisore në shtojcën 1.

⁶ Ju lutem shihni kontributin e dhënë nga folësi i dytë i sesionit për Qeverisje Mjedisore në shtojcën 1.

⁷ Shihni kontributin e dhënë nga z. Zeqir Veselaj (REC) në sesionin e Qeverisjes Mjedisore në shtojcën 1.



HAZBIJE IBISHI DHE QIBRIJE HOXHA

Në vitet e fundit, shtetet dhe subjektet e Evropës Juglindore kanë bërë një përparim të dukshëm në plotësimin e obligimeve të tyre brenda Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA). Mirëpo arritjet e Evropës Juglindore në procesin e përafrimit të ligjeve mjedisore dallojnë nga vendi në vend. Përderisa Kroacia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (të dyja shtete kandidate për hyrje në BE) janë relativisht të avancuara në bërjen e ligjeve, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova vetëm sa kanë filluar procesin e tyre të përafrimit. Në Kosovë Agjencia për Integritet Evropian monitoron përputhshmërinë e projektlegjislacionit me kërkesat e BE-së. Veç kësaj, përmes planit të saj gjashtëmujor të veprimit, Agjencia vendos prioritetet për Qeverinë e Kosovës në rastet e hartimit të legjislacionit të ri, siç ishte edhe rasti me projektligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Qasja në informata dhe pjesëmarrja e publikut
Në legjislacionin e shteteve dhe subjekteve të Ev-

ropës juglindore, qasja në informata dhe pjesëmarrje publike zakonisht përmenden si parime në ligjet kornizë.⁸ Nganjëherë rregullat për qasje në informata janë sqaruar në detaje, por pa dhënë garanci të nevojshme ligjore. Deputetët treguan që sa i përket të drejtave për pjesëmarrjen e publikut zbatimi dhe implementimi ishin edhe më pak efektive.⁹

Shqyrtimi i përputhshmërisë me Konventën e Aarhus-it në legjislacionin aktual në Kosovë është prezantuar nga përfaqësuesi i zyrës së REC-it në Kosovë, duke treguar një numër të lëshimeve dhe mangësive. Për shembull, parimi i pjesëmarrjes publike në ligjin për mbrojtjen e mjedisit duhet në mënyrë të qartë të theksojë të drejtën e publikut për t'u informuar lidhur me proceset vendimarrëse në mënyrë adekuate, me kohë dhe efektive. Ngjashëm me Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit, ai përmban instrumente të pamjaftueshme ligjore për të mundësuar qasjen në të dhënat e ndotjes. Ai gjithashtu nuk i siguron parimit të pjesëmarrjes publike një vend të merituar në strukturën e përgjithshme.

⁸ Për më tepër informata lidhur për diskutimet lidhur Konventën e Aarhus-it, ju lutem shihni raportin e seancës në shtojcën 1.

⁹ Morina V. (2006), "Inkorporimi i Konventës së Aarhus-it për Pjesëmarrje të Publikut në Vendimarrje dhe Qasje në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa e Aarhus-it) në legjislacionin e Kosovës", Raporti i Vlerësimit, REC, Prishtinë, f. 7.

Menaxhimi i ujerave

Disa deputetë nga rajoni theksuan, që kompetencat ligjore të menaxhimit të ujërave dhe mbrojtja e ujit janë shpeshherë të ndara nëpër shumë ministri. Në shumicën e Evropës Juglindore, ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhim të ujit nuk janë përgjegjëse vetëm për furnizimin me ujë por edhe për çështjet e mbrojtjes së ujit. Por jo-rrallë ministrinë tjera gjithashtu kanë kompetenca në këtë fushë, e që nganjëherë përsëriten. Në çdo shtet apo subjekt, komunat kishin kompetenca të caktuara në menaxhimin e ujit në nivel lokal; këto detyra aktuale të përfshira zakonisht janë ndarë me ndërmarrjet publike të themeluara për këtë qëllim.

Ndonëse, shumica e shteteve dhe subjekteve kanë zhvilluar ligje të reja kornizë për ujin në disa vitet e kaluara, disa fusha të rëndësishme – përfshirë edhe atë se si definohet përdorimi i ujit dhe si të themelohen sisteme funksionale të lëshimit të lejeve dhe kontrollit – mbesin ende të parregulluara. Në shumë mënyra, qasja institucionale dhe rregullatore e Kosovës ishte përshëndetur nga deputetët nga rajoni dhe ishte konsideruar se është në përputhshmëri me kërkesat e BE-së. Shumica e kompetencave i përkasin një ministrie (Ministria së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor). Akterë tjerë të rëndësishëm në këtë sektor janë ndërmarrjet e furnizimi me ujë dhe autoritetet komunale. Sidoqoftë, Kosova është subjekti i vetëm në rajon që ende nuk e ka planin e trajtimit të ujit.

Gjatë konferencës, përfaqësuesit shqiptar iniciuan idenë e mbajtjes së një konference rajonale të radhës me përqendrim në mbrojtjen e ujërave tejkufitare të ujërave të lumenjve siç është rrallësia dhe varësia për burime të ujërave si çështje ndërkombëtare.

Menaxhimi i cilësisë së ajrit

Deputetët nga rajoni kanë pranuar se mbrojtja e ajrit në nivel të BE-së rregullohet përmes matësve të cilësisë së ajrit, standardeve të emetimit dhe rregullimit e drejtpërdrejtë të teknologjisë së kërkuar brenda regjimit të ndotjes së integruar, parandalimit dhe kontrollit. Legjislacioni për cilësi të ajrit në Evropën Juglindore i plotëson këto kërkesa pjesërisht. Në përgjithësi, mbrojtja e ajrit bie nën kompetencat e ministrive të mjedisit, ndonëse nganjëherë aspektet shëndetësore të cilësisë së ajrit delegohen në ministrinë e shëndetësisë. Edhe pse të gjitha shtetet dhe subjektet e përfaqësuar në konferencë kanë nxjerr ligje të reja për mbrojtjen e ajrit, ato janë ligje kornizë të cilat ende kërkojnë legjislacion sekondar, posaçërisht sa i përket standardeve të emetimit, vlerave të cilësisë së ajrit dhe detajeve lidhur me procedurat e lëshimit të lejeve dhe monitorimit. Standardet ekzistuese për emetim dhe standardet për cilësinë e ajrit ose janë përmendur në mënyrë të përgjithshme ose janë bazuar në vlerat e vendosura gjatë viteve 1990 apo ndoshta edhe 1980, dhe kështu nuk i kanë dështuar në përmbushjen e standardeve të BE-së.

AJSHE SELMANI, SADUDIN BERISHA DHE SABRI HAMITI



Zyrtarët nga Ministria e Mjedisit në Kosovë kanë raportuar që kontribuuesit më të mëdhenj në ndotjen e ajrit në Kosovë janë qendrat e urbanizuara, emetues të mëdhenj siç janë termocentralet për prodhimin e energjisë, sektori i transportit, vendet industriale (metalurgjia, fabrikat, minierat dhe fabrikat e çimentos), veprimtaritë në bujqësi dhe vendet e paligjshme të hedhjes së mbeturinave. Cilësia e ajrit në mjedis është posaçërisht e dobët në vendet e zhvilluara urbane në Kosovë, posaçërisht në qytetin e Prishtinës/Priština. Termocentralet janë burimi kryesor i ndotjes së vazhdueshme të ajrit.

Fabrika e çimentos Sharcem, në Han të Elezit/Đeneral Janković (që ndodhet afër kufirit me IRJ të Maqedonisë), është një ndotës tjetër. Mirëpo, sipas Planit Kosovar të Veprimit për Mjedisin, pas një studimi të kësaj fabrike përmes vlerësimit të ndikimit në mjedis, menaxhmenti ka ndërmarrë masa të caktuara për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit.¹⁰ Sidoqoftë, një nivel i përgjithshëm i ulët i vetëdijes së ndërmarrësve, konsumatorëve dhe publikut të përgjithshëm lidhur me cilësinë e ajrit, kontribuon në situatën aktuale.

Menaxhimi i mbeturinave

Trajtimi i mbeturinave mbetet një nga problemet më të mëdha në rajonin e Evropës Juglindore. Legjislacioni përkatës është i ndarë dhe nuk përmban rregulla të mjaftueshme. Për të lehtësuar këto probleme, vitet e fundit disa shtete dhe subjekte kanë miratuar ligje kornizë për menaxhimin e mbeturinave (p.sh. Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Bile edhe shteteve më të avancuara (Bullgaria) ende i nevojiten akte ligjore shtesë, në mënyrë që sistemi i menaxhimit të mbeturinave të jetë në përputhshmëri me kërkesat e BE-së.

Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk posedon të dhëna në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar lidhur me gjenerimin, grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe

hedhjen. Në Kosovë nuk bëhet asnjë klasifikim i mbeturinave, riciklim apo trajtim. Së voni, Ministria e Mjedisit në Kosovë ka filluar një program për themelimin e një sistemi për klasifikimin e mbeturinave plastike dhe paketimin e mbeturinave për qëllim të riciklimit. Mirëpo, problemet kryesore nuk kanë të bëjnë me mbeturinat e ekonomive familjare. Plani Kosovar i Veprimit për Mjedisin bënë me dije se nuk ekziston ndonjë sistem për mbledhjen dhe hedhjen e mbeturinave të vajrave të përdorura, baterive, akumulatorëve, gomave, pajisjeve elektrike, veturave, mbeturinave bujqësore (kafshëve dhe bimëve), mbeturinave mjekësore, barërave me afat të skaduar, pesticideve dhe produkteve të ngjashme.¹¹

Ndotja Industriale

Përderisa lejimi i veprimtarive industriale është adresuar në masë të gjerë në Evropën Juglindore, rreziqet industriale janë trajtuar shumë pak në rajon. Si rrjedhojë, shumica e shteteve dhe subjekteve kanë shumë pak ose pothuajse nuk kanë fare legjislacion lidhur me menaxhimin dhe parandalimin e rreziqeve industriale. Në shumicën e rajonit, është ende pikëpyetje se deri në çfarë mase sistemet e lëshimit të lejeve janë në përputhshmëri me Direktivën për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes së integruar. Vetëm qeveria e Ish Republikës Jugosllave të Jugosllavisë ka aplikuar një qasje integruese të lëshimit të lejeve për operatorët industrial dhe ka integruar konceptin e parandalimit dhe kontrollimit të ndotjes së integruar në legjislacionin e saj.¹²

Sipas Planit Kosovar për Veprim në Mjedis, Kosova hyn në grupin e territoreve më të ndotura në Evropë.¹³ Zhvillimi industrial në Kosovë karakterizohet me një eksploatim të gjerë të pasurive natyrore, që i ka shkaktuar dëme të mëdha mjedisit. Veç kësaj, me fillimin e aktiviteteve prodhuese në sektorin privat, pas privatizimit të ndërmarrjeve, është ushtruar presion shtesë mbi mjedisin. Kjo gjë mund të lehtësohet me miratimin dhe zbatimin e Ligjit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Ligjit mbi vlerësimin strategjik mjedisor.

¹⁰ MMPH (2006), "Plani Kosovar i Veprimit për Mjedisin 2006-2010", Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, fq. 28.

¹¹ MAPH (2006), po aty fq. 49.

¹² Për më tepër informata ju lutem shihni kontributin e folësit të dytë të seancës lidhur me përafrimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin në shtojcën 1.

¹³ MAPH (2006), "Plani kosovar për veprim në mjedis 2006-2010", Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, fq. 71.

Konkluzionet dhe rekomandimet
Konferenca Rajonale Parlamentare për mjedisin ofroi mundësi për vendimmarrësit në rajon, veçanërisht për parlamentarët që të gjejnë pika të përbashkëta për bashkëpunim në të ardhmen. Për të adresuar çështjen e mbrojtjes së mjedisit, kërkohet qeverisje e fortë mjedisore. Në disa vitet e fundit, të gjitha vendet dhe subjektet e EJK-së kanë miratuar disa ligje primare për mjedisin. Veç kësaj, në disa vende janë miratuar ligje të veçanta për çështjet e ndërlidhura si: vlerësimi i ndikimit në mjedis, vlerësimi strategjik mjedisor dhe lejet për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. Meqenëse, këto rregullore gjenden mu në zemër të legjislacionit mjedisor, pjesëmarrësit e konferencës u pajtuan që ky është një hap i rëndësishëm.

Implementimi i Konventës së Aarhus-it duhet të realizohet, duke siguruar pajtueshmëri me legjislacionin mjedisor primar dhe sekondar. Kjo do të rezultojë me një mjedis inkurajues për pjesëmarrësit e organizatave të shoqërisë civile dhe publikut në proceset vendimmarrëse mjedisore. Në përgjithësi, Kosova nuk duhet ta bëjë asnjë përjashtim nga kjo praktikë, përkundër mungesës së anëtarësisë në Konventë.

Konferenca shërbeu si platformë për debatim dhe prezantim të ideve. Gjithashtu, aty u ofruan edhe një numër konkluzionesh:

- 1) T'i kushtohet më shumë vëmendje implementimit të ligjeve dhe politikave lidhur me mjedisin.
- 2) Disa ekspertë ndërkombëtarë dhe parlamentarë nga rajoni theksuan, që shoqëritë e rajonit duhet ta shtojnë bashkëpunimin dhe përmirësojnë shkëmbimin e informatave, në mënyrë që t'i shmangen gabimeve të disa vendeve tjera në tranzicion.
- 3) Për të pasur një qeverisje të mirë, është e domosdoshme që të sigurohet vendosja e proceseve të mirëfillta demokratike përmes sigurimit të së drejtës së qytetarëve për të pasur qasje në informata, vendimmarrje dhe drejtësi - të gjitha këto të parapara në Konventën e Aarhus-it.
- 4) Pjesëmarrësit e konferencës e pranuan që duhet të gjendet një baraspeshim ndërmjet zhvillimit ekonomik, mirëqenies së qytetarëve dhe mjedisit të pastër.
- 5) Një zgjidhje kornizë e mundshme për dilemën e lartpërmendur janë politikat dhe direktivat e Bashkimit Europian mbi mjedisin. Megjithatë, do t'i lihet shoqërive aspiruese ta zgjedhin shtegun dhe mekanizmat e tyre për t'i arritur synimet e përmendura më lartë.

Rekomandime

Për Kuvendin e Kosovës:

- Të siguroj përfshirjen e akterëve të ndryshëm dhe publikut të gjerë në rishikimin e legjislacionit mjedisor;
- Të mbikëqyrë rregullisht punën e agjencive ekzekutive që janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
- Të raportoj mbi implementimin e legjislacionit mjedisor tanimë të miratuar;
- Të shtoj bashkëpunimin e bashkërendimin ndërmjet Komisionit të Kuvendit për Mjedis dhe Komisionit të Kuvendit për Buxhet e Financa, në mënyrë që të ketë zbatim të ligjeve mjedisore të miratuara në Kuvend;
- Të inkurajojnë qeverinë që ajo të përcaktojë mbrojtjen e mjedisit si fushë me prioritet; dhe
- Të inkurajoj bashkëpunimin me parlamentet fqinje në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Për qeverinë e Kosovës:

- Të përgatisë gjithë legjislacionin primar dhe sekondar që i adresohet problemeve mjedisore;
- Të kryej themelimin e të gjitha agjencive ekzekutive siç kërkohet nga legjislacioni mjedisor;
- Ta caktoj mbrojtjen e mjedisit si fushë me prioritet;
- Ta rrisë buxhetin për projektet lidhur me mjedisin;
- T'i jap përparësi përafritim të legjislacionit mjedisor të BE-së; dhe
- Të përcaktoj mekanizma për përfshirjen e akterëve të ndryshëm dhe publikut të gjerë në rishikimin e legjislacionit mjedisor.

Për organizatat kosovare të shoqërisë civile:

- Të ndërmarrë një qasje proaktive gjatë shqyrtimit të legjislacionit mjedisor;
- Të shërbejë si urë komunikimi me Qeverinë dhe Kuvendin për qytetarët e prekur me gjendjen e mjedisit; dhe
- Të inkurajoj mbështetjen publike nga komunitetet e prekura për nismat mjedisore tejkuftare (p.sh. Parku Nacional i Paqes, Mbrojtja e lumit Drin dhe Parku Nacional Tejkufitar i Maleve të Sharrit).

Për OSBE-në:

- Të vazhdoj mbështetjen e Komisionit të Kuvendit për Mjedis në ngritjen e kapaciteteve për kontrollimin e punës së agjencive ekzekutive në fushën e mjedisit dhe të mbikëqyrë implementimin e ligjeve mjedisore;
- Të lehtësoj qasjen ndërsektorale ndërmjet fushës ekonomike, sociale, shëndetësore dhe mjedisore;
- Të lehtësoj shkëmbimin ndërparlamentar në fushën e mjedisit; dhe
- Të siguroj këshilla ekspertësh mbi çështjet mjedisore nga lista e ekspertëve mjedisor në Misionet e OSBE-së në EJK dhe Zyrën e Koordinatorit të OSBE-së për çështje ekonomike



SHTOJCA E PARË – Procesverbali i konferencës

Fjala hyrëse e z. Markku Laamanen, Zëvendës Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë në Konferencën Rajonale Parlamentare për mjedisin



MARRKU LAAMANEN

19 tetor, 2007

Kosova po përballet me një sërë problemesh mjedisore. Këto probleme janë kryesisht pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të pasurive natyrore dhe minerale në dekadat e fundit; prodhimit industrial, i cili nuk i ka marrë parasysh standardet minimale për mjedisin; mungesës së sistemeve të duhura për menaxhimin e mbeturinave, duke u përqendruar në grumbullimin e gjithmbarshëm të të gjitha llojeve të mbeturinave dhe sistemeve të hedhjes së tyre në mbarë Kosovën; mungesës së sistemeve monitoruese të mjedisit; dhe nivelit të ultë të sensibilizimit për sa i përket nevojës për ruajtjen e natyrës.

Kjo gjë ka rezultuar me ndotjen e konsiderueshme të ujit, tokës, dhe ajrit, duke shkaktuar ndikime negative direkte dhe indirekte në ekosisteme dhe shëndetin publik. Bashkësia Evropiane këmbëngul në implementimin e standardeve mjedisore të BE-së në tërë rajonin e Evropës Jug-Lindore. Kjo gjë duhet të mirëpritet, por mund të realizohet vetëm përmes bashkëpunimit rajonal, duke iu adresuar problemeve të zakonshme dhe çështjeve mjedisore tejkuftare. Për shembull: termocentralet me linjit të Kosovës i ndotin ujërat e lumit Ibër dhe si rrjedhim edhe Moravën e Danubin, duke shkuar poshtë rrjedhës deri në Detin e Zi; ose fabrika e çimentos në Han të Elezit, e cila e ndot ajrin deri në Shkup.

“Kush e ka lejuar që kjo gjë të ndodhë? Kush është përgjegjës për këtë rrëmujë? Si mund t'i zgjedhim këto probleme?” Këto janë pyetje tipike, që njerëzit ua parashtrajnë vetes kur ndodhin katastrofa mjedisore ose kur në lajme jepet ndonjë ndodhi për shkatërrimin e vazhdueshëm të mjedisit në nivelin global. Për shumicën e njerëzve nuk është e qartë se kush është “përgjegjës” për mjedisin dhe se si politikatat e integruara për mjedisin duhet të zhvillohen dhe të vihen në zbatim.

Që nga Samiti për Tokën në Rio de Janeiro në vitin 1992, konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm – zhvillim që siguron se sot shfrytëzimi i pasurive dhe mjedisit nuk e kufizon shfrytëzimin e tyre nga gjeneratat e ardhshme – prandaj qëndrueshmëria në marrëdhëniet e shumënduarshme ndërmjet njeriut dhe mjedisit janë bërë rregulla integruese të mirësjelljes në politikë dhe shoqëri.

Megjithatë, realizimi i mjedisit të pastër dhe të qëndrueshëm paraqet një sfidë të madhe për shkak të zhvillimit ekonomik, shtimit të numrit të popullatës dhe tendencës për lëvizje nga zonat rurale në qendrat urbane. Shfrytëzimi i tepruar i pasurive natyrore është një prej çështjeve problematike kur bëhen përpjekje për të arritur nivel më të lartë të qëndrueshmërisë, siç mbetet sfidë edhe dakordimi lidhur me baraspeshimin ndërmjet prioriteteve ekologjike, ekonomike dhe sociale. Është menduar gjatë, që mirëqenia dhe mjedisi janë përgjegjësi vetëm e qeverive.

Në ditët tona, bashkërendimi tradicional hierarkik nga qeveritë dhe administratat është zëvendësuar me mekanizma bashkërendimi rrjetor dhe qasje të përqendruar në treg duke përfshirë nivele të ndryshme shoqërore. Kufijtë e paqartë funksional, strukturor dhe territorial shihen si arsye kryesore për kalim nga drejtimi hierarkik nga qeveritë tek rregullimi nga organizimet qeveritare duke përfshirë njëkohësisht akterët privat dhe publik.

Qeverisja ka të bëjë me vendimet dhe se si i marrim ato. Ka të bëjë me zhvillimin e politikave të duhura dhe implementimin efikas të tyre gjatë ushtrimit të pushtetit; me qenien “përgjegjës.” Është e ndërlidhur me vendimmarrësit në të gjitha nivelet – udhëheqësit e qeverisë dhe ministrat, afaristët, pronarët e pronave, bujqit, OJQ-të dhe konsumatorët. Shkurt, ajo ka të bëjë me atë se kush është përgjegjës, si i ushtrojnë kompetencat e tyre dhe si ata mbahen përgjegjës.

Parakusht i çdo qeverisjeje efektive të mjedisit është mbikëqyrja e mirëfilltë e politikave ekzekutive, në

mënyrë që të arrihet qeverisje efektive demokratike. Kjo kërkon përfaqësues të përgjegjshëm të zgjedhur në të gjitha nivelet dhe në nivel qendror të Komisioneve efikase, siç është Komisioni për Mjedis, që është i aftë për ta mbështetur zhvillimin e politikave të qëndrueshme mjedisore, për ta shqyrtuar legjislacionin dhe rregulloret e propozuara, për ta monitoruar efikasitetin e implementimit të legjislacionit të miratuar, për të realizuar dëgjime hetuese dhe të luaj rol in kyç në rrjetet rajonale.

Brenda OSBE-së ekziston mendimi, që investimi në zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit është çelës për krijimin e sigurisë dhe stabilitetit lokal

dhe rajonal. Gjithashtu, shpeshherë është çështje e nënvlerësuar e të drejtave të njeriut, meqë ndotja dhe shfrytëzimi i paqëndrueshëm i pasurive të çmuara ndikon së pari tek anëtarët më të rrezikuar të shoqërisë siç janë pakicat, fëmijët dhe të moshuarit.

Misioni i OSBE-së në Kosovë përmes kësaj konference synon të demonstroj se si progresi i mëtejshëm në fushat si pjesëmarrja publike, llogaridhënia, mbikëqyrja parlamentare, sundimi i ligjit, ofrimi i shërbimeve të sektorit publik dhe decentralizimi mund të nxisin përfitime më të madha sa i përket qeverisjes së mirë dhe ruajtjes së mjedisit.

Fjala hyrëse e z. Sabri Hamiti, ish anëtarë i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës në Konferencën Rajonale Parlamentare për Mjedisin (Mandati i Kuvendit 2004-2007)

19 tetor, 2007

Kam kënaqësinë dhe nderin të ju shpreh mirëseardhje në Kosovë. Jam i kënaqur që Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me OSBE-në, ka organizuar këtë konferencë Rajonale Parlamentare. Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues po zhvillohet në një Kuvend demokratik me procedurat dhe funksionin e tij: duke hartuar ligje dhe duke përcjellë zbatimin e tyre.

Kuvendi i Kosovës, si e gjithë shoqëria, tani gjendet para dy sprovave të mëdha, zgjedhjeve kombëtare e komunale dhe definimit të statusit politik të Kosovës, në bazë të vullnetit të qytetarëve. Një Kosovë e pavarur dhe demokratike tanimë është çështje ekzistenciale për qytetarët e Kosovës, dhe do të shërbej si dhe faktor stabiliteti në rajon e më gjerë.

Kosova e shqiptarët dhe qytetarët e saj gjeografikisht, historikisht e kulturalisht janë evropiane por dëshirojnë të bëhen evropiane dhe politikisht nëpërmjet integriteteve e standardeve evropiane.

Konferenca që po fillon, pos rëndësisë që ka për trajtimin e problemit mjedisor, ka edhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërparlamentar në rajon.

Kuvendi i Kosovës, duke pasur një konsensus të plotë për çështjet mjedisore, ka aprovuar një mori ligjesh për ambientin, duke pasur parasysh rrethanat e vendit dhe standardet evropiane. Çështja është si të zbatohen ligjet në vendin e rrënuar e të dërrmuar nga lufta.

Çështja e ambientit është çështje e jetës dhe ka



SABRI HAMITI

dimensionet konkrete e universale, në këtë vështrim i shohim me dobi të madhe observimet dhe përvojat që do të shpalohej këtu për dy ditë punë. Toka, uji e ajri, ashtu si edhe liria, janë për të gjithë dhe, duke ruajtur këto, ruhet ambienti i shoqërisë njerëzore. Këto nuk janë çështje vetëm për përfaqësuesit, por për të gjithë qytetarët.

Duke ju përshëndetur edhe një herë, në emër të Kuvendit të Kosovës, ju dëshiroj qëndrim të këndshëm në Kosovë, ju dëshiroj sukses në Konferencë dhe ju lë kohën që të shfaqni idetë dhe përvojat tuaja.

Raportet e seancës

Sqarim

Pikëpamjet e shprehura këtu paraqesin mendimet e folësve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e organizatave të tyre ose të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

SEANCA I:

“Qeverisja e mjedisit”

Moderator: Lulzim Zeneli, Kuvendi i Kosovës

Folësi kryesor: Andrew Farmer, Instituti për Politika Mjedisore Europiane

Folësi kryesor: Merxhan Avdyli, Zëvendës Ministër për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Folësi kryesor: Lodewijk Vanoost, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Përgjegjësi: Shaban Halimi, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi Rajonal: Sanda Redžić, Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës

Folësi kryesor i parë -

Andrew Farmer

Folësi kryesor i parë theksoi që qeverisja efektive e mjedisit është e nevojshme për të arritur si objektivat mjedisore vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, por kjo gjithashtu ka ndikim mbi zhvillimin socio-politikë në vend. Meqenëse ka ndikim direkt mbi individ, mjedisi ofron një forum ideal përmes së cilit inkurajon pjesëmarrjen e publikut dhe akterëve në procesin politikë. Ai gjithashtu, ofron një mundësi për bashkëpunim zyrtar me partnerët ndërkombëtarë dhe rajonal në çështjet tejkuftare, siç është menaxhimi i ujit.

Dy prioritetet të identifikuar nga folësi përfshijnë lidhjen ndërmjet mjedisit dhe shëndetit publik (p.sh. hedhja e substancave toksike) dhe nevoja për të siguruar, që rregulloret të janë të realizueshme dhe të zbatueshme në praktikë brenda kornizave të përcaktuara kohore.

Në disa rekomandime të folësit është përfshirë nevoja për analiza efektive, angazhim të akterëve dhe bashkëpunim ndërmjet zyrtarëve qeveritar dhe parlamentarëve. Shumë ligje të BE-së për mjedisin theksojnë përfshirjen e akterëve, (p.sh. planifikimi i menaxhimit të pellgut të lumit) ku ata mund të ofrojnë kontribute të çmueshme në ligjëbërje. Parlamentet luajnë rol kyç në procesin e hyrjes në BE, me kusht që të mos kërkohet nga parlamentarët që thjeshtë “t’i miratojnë automatikisht” kërkesat e BE-së. Shumë obligime të BE-së kërkojnë që të merren parasysh kushtet vendore dhe konteksti ligjor (duke përfshirë ligjet ekzistuese), që ofrojnë mundësi për angazhimin e parlamenteve.

Folësi kryesor i dytë-

Merxhan Avdyli

Folësi kryesor i dytë theksoi rëndësinë e krijimit të kornizës ligjore dhe të politikave për qeverisjen e mirë të mjedisit. Të gjitha ligjet e Kosovës, që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujit dhe

mbeturinave, duke përfshirë legjislacionin sekondar janë në pajtim me direktivat Evropiane.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka hartuar tri dokumente të rëndësishme për planifikimin e politikave “Strategjia për Mjedis të Qëndrueshëm dhe Zhvillim 2005-2015”, “Plani Kosovar për Veprim në Mjedis 2006-2010” dhe “Plani Hapësinor i Kosovës 2005-2015”. Folësi shtojë se çështjet mjedisore janë çështje universale dhe si të tilla mund të ndihmojnë në krijimin e marrëdhënieve të mira ndërmjet shoqërive. Bashkëpunimi mjedisor, gjithashtu është një mjet i rëndësishëm i parandalimit të konflikteve.

Folësi vazhdoi duke përmendur Iniciativën ENVSEC, program ky i mbështetur nga UNEP-i, UNDP-ja, NATO-ja dhe OSBE-ja, për sa i përket bashkëpunimit rajonal për menaxhimin e zonave kufitare si dhe aspektet tjera mjedisore.

ANDREW FARMER





ANDREW FARMER, DAVID SWALLEY DHE MARIANNA BOLSHAKOVA

Folësi kryesor i tretë -

Lodewijk Vanoost

Interesimi dhe shqetësimi për çështjet mjedisore ka filluar në fund të viteve të '70-ta, kur ndotja e ujit dhe smogu u bënë çështje diskutimi në debatet politike. Ringjallja ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore dhe zhvillimi ekonomik i viteve të gjashtëdhjeta dhe në fillim të viteve shtatëdhjeta solli një nivel të paparë të mirëqenies. Por, në të njëjtën kohë, te shumë prindër shqetësimi shtohet shume e më shumë rreth rritjes së numrit të fëmijëve me sëmundje të diabetit, alergji dhe leukemi si dhe shtimit të sëmundjeve të organeve të frymëmarrjes në përgjithësi.

Folësi theksoi, që opinioni publik i shtyu udhëheqësit politikë në Europë që të fillojnë hartimin e politikave mjedisore. Kundërgargumenti i rishfaqur ishte që ekonomia jonë do të vuaj nga kufizimet e ashpra mjedisore. Kështu, parlamentet mbajtën seminare, ftuan ekspertë, realizuan vizita pune dhe i parashtruan pyetje qeverisë. Në fakt, sipas folësit, ishin institucionet parlamentare dhe jo qeveria që e dëgjoi më së shumti opinionin e publikut dhe ndër-morën iniciativa për përmirësimin e situatës.

Folësi vuri në dukje, që në ditët e sotme Belgjika ka

ligje, rregullore dhe kufizime në industri. Sa herë që kundërshtarët ngrinin zërin: "që kjo gjë do ta shkatërrojë ekonominë, konkurrentët tanë në vendet tjera do ta marrin pushtetin dhe shumë punë do të humben" dhe çdoherë parlamenti vazhdonte përpara, ndonjëherë më ngadalë, por megjithatë ecte përpara, mirëpo, çdoherë dëshmohej se kundërshtarët e kishin gabim dhe skenarët për fundin e botës kurrë nuk u realizuan.

Folësi kryesor përfundojë, duke thënë që, ndonëse ka mendime, që Kosova nuk ka ekonomi të fortë dhe që nuk ka fonde për të shpenzuar në mbrojtjen e mjedisit, BE-ja do të ofrojë ndihmë në këtë drejtim. Mirëpo, iniciativa do të duhet të merret nga përfaqësuesit e Kosovës.

Përgjegjësi i parë-

Shaban Halimi

Përgjegjësi i parë tha që në sistemin e kaluar komunist të qeverisjes, industria në Kosovë ka vepruar si prodhues i kemikaleve dhe ndotjes dhe nuk ka pasur asnjë konsideratë për mbrojtjen e mjedisit. Kjo konferencë do të ishte një mundësi e forcimit të bashkëpunimit në përpjekje për zgjidhjen e problemit. Përgjegjësi vuri në dukje përsëri çështjen e



MIRJANA BRNADIĆ, LULZIM ZENELI, SHABAN HALIMI
DHE BERAT LUZHA

mirëmbajtjes së kontakteve me qytetarët dhe shtimin e interesimit për mbrojtjen e mjedisit si dhe mirëmbajtjen e kontakteve me ndotësit e mjedisit. Përveç funksionit të tyre legjislativ, komisionet gjithashtu duhet ta mbikëqyrin implementimin e ligjeve. Në këtë pikë, Kosova është duke u përballur me probleme si në nivel të Kuvendit ashtu edhe në nivel të komisioneve. Një problem tjetër që është paraqitur, ishte gjatë miratimit të ligjeve, ku Kuvendi i Kosovës u përpoq të siguroj që ato të jenë në përputhje me ligjet e BE-së, përderisa nuk janë marrë parasysh vështirësitë me të cilat përballen vendet në tranzicion. Kjo vlen veçanërisht për vendet me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik.

Përgjegjësi i dytë- Sanda Redžić

Përgjegjësi i dytë filloi duke e vënë në pah që Bosnja e Hercegovina është duke përjetuar përvoja të ngjashme me ato të paraqitura nga përgjegjësi i parë. Implementimi i ligjeve në Bosnjë e Hercegovinë, në fushën e mbrojtjes së mjedisit është i ndërlikuar për shkak të rregullimit kushtetues, ngase përbëhet prej dy subjekteve me kompetenca të ndara për mje-

disin. Në nivel shtetërorë, nuk ka asnjë Ministri të Mjedisit, përderisa mjedisi trajtohet në mënyrë simbolike në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Marrëdhënie Ekonomike. Përgjegjësi prezantoi politikat strategjike mjedisore dhe dokumentet ligjore, të cilat janë miratuar nga të dy subjektet: Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Serbe.

Diskutim

Implementimi i ligjeve dhe mbrojtja e mjedisit mund të jetë e vështirë për një sërë arsyesh. Kjo shkon sipas aksiomës së Benjamin Franklin-it "Ligjet e buta rrallëherë respektohen; e ato shumë të forta, rrallëherë ekzekutohen". Mund të ekzistojnë një sërë faktorësh, të cilët shkaktojnë probleme në zbatim. Kapaciteti i autoriteteve zbatuese mund të jetë joadekuat (p.sh. numri i stafit, ekspertët, pajisjet etj.) Kjo është e qartë, veçanërisht kur autoritetet papritmas përballen me obligime të reja, që u imponohen atyre përmes legjislationit të ri. Mund të ketë kufizime në instrumentet ligjore (p.sh. gjobitjet ose dënimet tjera mund të mos jenë të mjaftueshme për ndryshimin e sjelljes). Mund të ketë kundërshtime politike (p.sh. ligji mbi mjedisin mund të kërkoj mbylljen e fabrikës, por kjo kundërshtohet nga komuniteti vendor). Është me rëndësi të shikohet legjislationi për mjedisin si pjesë e zhvillimit të gjerë politik dhe social. Parlamentarët luajnë një pjesë të rëndësishme duke kontrolluar ligjet, duke marrë parasysh praktikën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

Ndërlidhja e nismave mjedisore me sigurinë

OSBE-ja i ndihmon vendet dhe subjektet e rajonit përmes Iniciativës për Mjedis dhe Siguri (ENVSEC), në partneritet të përbashkët me UNDP-në, UNEP-in dhe NATO-n. Ky bashkëpunim bazohet në parimin, që shtetet së bashku me partnerët ndërkombëtarë të zhvillojnë programe, që adresojnë çështje mjedisore para se ato të bëhen kërcënim për sigurinë. Veç kësaj, kjo iniciativë ofron mundësi bashkëpunimi ndërmjet vendeve fqinje për çështje mjedisore, veçanërisht në fushën e menaxhimit të ujit, pylltarisë, zhvillimit urban dhe mjedisor. Sekretariati i OSBE-së vazhdon të punoj me pikat fokale nacionale nëpër ministri dhe agjenci si dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Përfundimisht, qasja e OSBE-së është e drejtuar kah zhvillimi i mekanizmave për zgjidhjen e problemeve mjedisore përmes bashkëpunimit ndërmjet fqinjëve.

SEANCA II:

“Parimet e Konventës së Aarhus-it – Qasja në informata, vendimmarrje dhe drejtësi – praktikat nga Evropa dhe Rajoni”

Moderator: Fetah Berisha, Kuvendi i Kosovës

Folësja kryesore: Marianna Bolshakova, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën – Sekretariati i Konventës së Aarhus-it

Folës kryesor: David Swalley, Veprimtaritë Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së

Folës kryesor: Zeqir Veselaj, Qendra Mjedisore Rajonale – Zyra në Kosovë

Përgjegjësi: Jusuf Sutaj, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi Rajonal: Idriz Xhomara, Kuvendi i Shqipërisë

Folësja e parë kryesore -

Marianna Bolshakova

Folësja kryesore e filloi prezantimin e saj duke ofruar disa fakte bazë mbi zhvillimin historik të Konventës së Aarhus-it dhe gamës së anëtarësisë. Edhe pse kufizohet në hemisferën Euroaziatike, Konventa ka fituar rëndësi globale duke u kthyer në sipërmarrjen më ambicioze në fushën e “demokracisë mjedisore” të ndërmarrë deri më tani

nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara. Folësja shtjellojë idenë që Konventa ka qenë model i qeverisjes së mirë mjedisore, duke theksuar aspektin e fuqishëm të pjesëmarrjes. Konventa e Aarhus-it ofron mekanizma për të siguruar përfshirje të gjerë të palëve të ndryshme të përfshira. Ajo pranon të drejtën për mjedis të shëndetshëm dhe pranon që qytetarët mund të kenë nevojë për ndihmë për të ushtruar të drejtat e tyre.

JUSUF SUTAJ, MARIANNA BOLSHAKOVA DHE FETAH BERISHA



Më tutje, traktati njihet nevojën e transparencës në gjitha degët e qeverisë dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe OJQ-ve në gjitha proceset e parapara sipas Konventës. Folësja vazhdoi duke theksuar rëndësinë e qeverisjes demokratike mjedisore. Sa i përket motivimit pragmatik, pjesëmarrja më e madhe do të çonte në vendim-marrje më të mirë dhe zbatim më të mirë të këtyre vendimeve. Qeverisja demokratike mjedisore do të ishte thelbësore në përforcimin e të drejtave të qytetarëve për pjesëmarrje dhe përfshirje në procedurat e vendim-marrjes dhe ligjvënies.

Folësja përmbledhi përmbajtjen e Konventës duke theksuar tri shtyllat e ndryshme të saj (qasja në informatave, pjesëmarrja publike dhe qasja në drejtësi) si dhe nënvizoi disa nga veçoritë e përgjithshme të Konventës. Sipas Folëses kryesore, shtylla e informimit është zbatuar gjerësisht në gjithë rajonin, edhe pse në disa raste mungesa e mjeteve financiare dhe vetëdijes së zyrtarëve lokalë pengon qasjen efektive të qytetarëve ndaj informatave. Shtylla e qasjes në drejtësi është më e injoruar nga gati të gjitha palët nënshkruese të Konventës, sidomos për shkak të ritmit të ngadalshëm të procedurave juridike. Sfida gjithashtu dalin për shkak të dështimit në përpilimin e legjislacionit të qartë, konsistent dhe gjithëpërfshirës.

Mungesa e vetëdijes dhe interesimit në nivelet lokale dhe krahinore, si dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare kontribuojnë në implementim jo-efektiv. Në vërejtjet e saj përfundimtare, folësja i kërkoi shteteve jo-nënshkruese të ratifikojnë Konventën sa më shpejt që është e mundur, ndërsa palëve të Konventës iu kërkoi të ndërtojnë një kornizë të qartë, transparente dhe konsistente ligjore në shtetet e tyre, në pajtim me dispozitat e Konventës. Kuvendet (parlamentet) duhet të marrin përsipër përgjegjësinë për sigurimin e masave efektive të zbatimit dhe për sigurimin e kapaciteteve të domosdoshme përmes buxhetit shtetëror.

Folësi i dytë kryesor -

David Swalley

Folësi i dytë kryesor prezantoi ndihmën e OSBE-së për qeveritë në implementimin e parimeve të Konventës së Aarhus-it. Duke marrë parasysh që OSBE-ja ndjek një parim gjithëpërfshirës të sigurisë, duke përfshirë dimensionin politik, atë ekonomik dhe atë njerëzor, kjo nënkupton që OSBE-ja ka të bëjë edhe me parandalimin dhe luftimin e kërcënimeve mjedisore, pasi që ato mund të ndikojnë



IDRIZ XHOMARA

seriozisht në sigurinë e shoqërive. Sa i përket Evropës Juglindore, për shembull, rajoni i është nënshtruar vërshimeve serioze dhe zjarreve të rrezikshme të pyjeve në verën e kaluar. Pasi mandati i OSBE-së përfshin edhe parandalimin dhe luftimin e kërcënimeve mjedisore, OSBE-ja ka shtyrë përpara ratifikimin dhe implementimin e Konventës së Aarhus-it në shtetet pjesëmarrëse qysh prej vitit 1999.

Që nga viti 2002, Zyra e Koordinatorit të Veprimtarive Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së (OCEEA) bashkë me zyrat e OSBE-së në terren, janë duke mbështetur ndërtimin e Qendrave të Aarhus-it në Kaukaz dhe Azi Qendrore. Qendrat janë dizajnuar si një urë mes qeverive dhe shoqërisë civile, duke nxitur kështu zhvillimin demokratik përmes promovimit të diskutimeve dhe takimeve mes qeverive dhe qytetarëve, mundësive të qytetarëve për të komentuar projektligjet, si dhe bazën ligjore për kërkesat e qytetarëve para gjykatave. Qendrat kontribuojnë në rritjen e transparencës së aktiviteteve qeveritare, si dhe legjislacionit mjedisor. Ato bazohen në premisën që qytetarët e përfshirë dhe të informuar kontribuojnë në politika të shëndosha, legjitime dhe efektive mjedisore.

Deri tani, OSBE-ja ka sponsorizuar themelimin e Qendrave të Aarhusit në Shqipëri, Armeni, Azerbajxhan, Gjeorgji, Kirgistan dhe Taxhikistan. Ato janë vendosur në lokacione të ndryshme, megjithatë ato më efektivet janë të vendosura drejtpërdrejt në Ministrinë e Mjedisit. Qendrat e Aarhus-it menaxhohen nga një Bord Menaxhues apo Bord Ekspertësh, të cilët përbëhen nga një numër i barabartë përfaqësuesish nga qeveria dhe shoqëria civile. Në disa vende, ka edhe Borde Këshilldhënëse që mbështesin punën e Qendrave të Aarhusit.

Këto borde mund të përbëhen nga organizatat donatore, ambasadat, organizatat e sektorit privat, si dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Qendrat zakonisht përmbushin kapacitetet analitike dhe qasëse të autoriteteve publike mjedisore duke ofruar qasje të lehtë për publikun dhe vendim-marrësit në informatat mjedisore në dispozicion. Për më shumë, ato bëjnë përpjekje të ofrojnë të gjitha informatat mjedisore në formate të lehta për përdoruesin, formate të popullarizuara dhe atraktive, si dhe të punojnë në mënyrë aktive për të ngritur vetëdijen publike mbi çështjet mjedisore.

Përveç këtyre, ato promovojnë pjesëmarrjen në vendim-marrje mjedisore duke organizuar dëgjime publike mbi projekt-legjislacionin, si dhe përmes këshillave juridike pa pagesë për qytetarët dhe organizatat në çështje mjedisore. Në disa raste, ministrinë e mjedisit kanë përdorur premiset e Aarhus-it edhe për trajnimin e punëtorëve qeveritarë në ligjin mjedisor shtetëror dhe mbi marrëveshjet shumëpalëshe ndërkombëtare. Koncepti i përgjegjësisë së përgjithshme shoqërore gjithashtu ka qenë objekt i veprimtarive të qendrave të Aarhus-it me angazhimin e përfaqësuesve të bizneseve lokale në diskutime dhe aktivitete në komunitet. Në shumë raste, qendrat gjithashtu ofrojnë një vend për aktivitete të sensibilizimit publik mjedisor për fëmijët e shkollave dhe si vend hulumtimi për studentë.

Folësi i tretë kryesor -

Zeqir Veselaj

Folësi e filloi prezantimin e tij me "Hapat drejt implementimit të Parimeve të Konventës së Aarhusit në Kosovë dhe rolin e shoqërisë civile në këtë proces" duke shpjeguar programin e Qendrës Mjedisore Rajonale (REC) për pjesëmarrjen publike në Kosovë. Programi përbëhet nga mbështetja dhe mundësimi i qasjes në informatave, pjesëmarrja e publikut në vendim-marrje mjedisore dhe qasja në drejtësi përmes ndërtimit të kapaciteteve, rrjetëzim-



DAVID SWALLEY

it, analizave politike dhe ligjore si dhe ndihmës për palë të ndryshme të përfshira. Folësi gjithashtu prezantoi projektin rajonal "Përmirësimi i Pjesëmarrjes Publike – Hapat drejt implementimit të Konventës së Aarhus-it", i cili përfshin organizimin e takimeve, trajnimeve dhe një punëtorie me Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Mjedis, për implementimin e Konventës së Aarhus-it në Kosovë. Përveç këtyre, Zyra e REC-it në Kosovë ka hartuar një doracak për zyrtarët komunalë të mjedisit. Ky doracak do të shërbejë si udhëzim për ndërtimin e mekanizmeve për të mundësuar qasje ndaj informatave dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje. REC-i gjithashtu ka ofruar trajnime për OJQ-të mjedisore kosovare.

Folësi paraqiti një raport të publikuar nga REC-i, i cili analizon mungesat ligjore dhe domosdoshmërinë e përligjjes së parimeve të Konventës së Aarhus-it në legjislacionin kosovar. Sipas raportit, dispozitat e Konventës janë mirë të mbuluara me legjislacionin aktual mjedisor. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit përfshin dy nga shtyllat e Aarhus-it (qasja në informata dhe qasja në drejtësi). Megjithatë, e treta shtyllë ende nuk është përfshirë në legjislacionin ekzistues, duke nënkuptuar që e drejta ndaj pjesëmarrjes publike nuk është përligjur ende.

Përgjegjësi i parë -

Jusuf Sutaj

Përgjegjësi shprehu domosdoshmërinë, që Kuvendi i Kosovës të përfshijë sa më shumë dispozita të Konventës së Aarhus-it që është e mundur në legjislacionin ekzistues, ndërkohë duke theksuar që disa nga dispozitat tanimë janë në fuqi. Përgjegjësi vazhdoi të theksonte që janë bërë arritje në zvogëlimin e ndotjes nga industria e rëndë. Në anën tjetër, ekziston një numër i madh i veturave në Kosovë, gjë që mbetet brengë. Ai përfundoi duke thënë që shumë ligje mjedisore janë tanimë në pajtim me dispozitat e Aarhusit, disa duke iu referuar në mënyrë eksplicite Traktatit, derisa të tjerët bazohen në frymën e Konventës.

Përgjegjësi i dytë -

Idriz Xhomara

Përgjegjësi i dytë mirëpriti paradigmen e re në fushën e mbrojtjes mjedisore që është krijuar nga Konventa e Aarhus-it. Ai gjithashtu theksoi vështirësitë specifike për vendet në tranzicion në implementimin e kësaj Konvente. Në anën tjetër, përgjegjësi nënvizoi që përderisa çështjet e veçanta ndërkuftare trajtohen në mënyrë efektive në marrëveshjet bilaterale, si për shembull traktati me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë mbi shfrytëzimin e ujit, fushat tjera brengosëse janë përjashtuar nga marrëveshja, siç është problemi i ndotjes në rritje.

Diskutimi

Konventa e Aarhus-it si mekanizëm për demokratizimin e shoqërive në tranzicion. Parimet e Konventës ofrojnë mekanizma për ndërtimin e urave të nevojshme mes popullit dhe qeverisë. Disa parlamentarë nga rajoni në mënyrë të veçantë theksuan rëndësinë e të pasurit të drejtë të qasjes publike në informata mbi çështjet mjedisore dhe për përfshirje në procesin e vendim-marrjes. Ndonëse vetëdija publike mbi domosdoshmërinë e mbrojtjes së mjedisit është tanimë në nivel të lartë, një folës u ankua që politika shpesh ndërhyr në çështje mjedisore në dëm të mbrojtjes mjedisore. Mbrojtja mjedisore nuk duhet përdorë për qëllime politike.

Veç kësaj, një nga gurthemet e Konventës së Aarhus-it është dispozita e së drejtës për mjedis të shëndetshëm, siç është theksuar në Nenin 1. Në të ardhmen, shtetet nënshkruese të Konventës mund të paditen për mos-sigurim efektiv të kësaj të drejte për qytetarët. Megjithatë, edhe pse Konventa garanton të drejtën e qasjes në informata lidhur me çështjet mjedisore, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që këto informata mund të qasen lehtësisht. Një folës propozojë që qasja në informata mund të lehtësohet në mënyrë të veçantë në fazën e ligjvënies. Për shembull, vënia e projektligjeve mbi çështjet mjedisore në dispozicion në versione elektronike të shpallura në Internet do të mund të ishte masë e thjeshtë, por efektive, e përmirësimit të qasjes në informata.

SEANCA III:

“Bashkëpunimi ndërkufitar në çështjet mjedisore: Sektori i energjisë”

Moderator: Peter Vanhoutte, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folës Kryesor: Lorik Haxhiu, Menaxher i Projektit në Zyrën e Projektit PATEL

Folës Kryesor: Ilir Morina, Udhëheqës i Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

Folës Kryesor: Luan Shllaku, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqërinë e Hapur

Përgjegjës: Berat Luzha, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjës rajonal: Petar Beron, Parlamenti i Bullgarisë



Folësi i parë kryesor

Lorik Haxhiu – Menaxher i Projektit, Zyra e Projektit PATEL

Folësi prezantoi Strategjinë e Energjisë të Kosovës (SE) që është hartuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave të Kosovës (MEM), të miratuar nga Qeveria dhe nga Kuvendi i Kosovës më 2005. Strategjia është rezultat i studimeve të shumta të kryera para vitit 1999, e sidomos pas vitit 1999. Ajo vijëzon zbulimet në vijim: Kosova ka nevojë për më shumë energji sesa që prodhohet në vend; konsumi vendor i energjisë është në rritje; si dhe mungesa e kapaciteteve gjeneruese në rajon është evidente dhe ndikon në çmimet e energjisë së importuar. Strategjia rekomandon si në vijim: rehabilitimin e termocentraleve ekzistuese për të mbuluar kërkesën afatshkurtër dhe afatmesme; ndërtimin e

një termocentral i ri që do të sigurojë furnizim të qëndrueshëm të energjisë në afat të gjatë, si dhe duke pasur para sysh që të dyja janë të bazuara në linjitin vendor, të ndërtohet një minierë e re e linjtit. Për implementimin e kësaj strategjie, ka nevojë për investime të mëdha kapitale.

Qeveria e Kosovës është në kërkim të investimeve direkte të huaja për ndërtimin e tre elementeve të projektit të cilat janë: ndërtimi i minierës së Sibocit; rehabilitimi i disa blloqeve të termocentralit më të vjetër, Kosova A, si dhe ndërtimi i termocentralit të ri, Kosova C. Për zhvillimin optimal të resurseve energjetike të Kosovës si dhe për t'u siguruar që ky proces të jetë në përputhje me legjislacionin evropian, janë ndërmarrë këta hapa: është themeluar një Komitet Drejtues i Projektit – organi vendim-marrës – si dhe Zyra e Projek-

tit në Kosovë; janë angazhuar këshilltarët të cilët do të punojnë në çështjet ligjore dhe rregullative, dhe në ato mjedisore dhe masat mbrojtëse sociale, për të hartuar një propozim transaksioni i cili do t'i lëshohet edhe zyrtarisht ofertuesve. Ky Projekt është i mbështetur nga Qeveria, Kuvendi i Kosovës, dhe donatorët si USAID, Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian.

Sa i përket efikasitetit të prodhimit, kur Kosova A është ndërtuar, ajo shfrytëzonte 2 tonë thëngjill për prodhimin e 1 megavati energji; kur u ndërtua Kosova B në vitet e 80-ta, përdorte 1.5 ton thëngjill për prodhimin e një megavati; ndërsa me teknologji të re tani mund të prodhohet një megavat me 1 ton thëngjill; kështu, lënda djegëse e nevojshme për të njëjtën sasi të energjisë është përgjysmuar. Projekti i Asistencës Teknike për Energjinë nga Linjiti (PATEL) udhëhiqet nga parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. Korniza e masave mbrojtëse përcakton standardet dhe qasjen për të siguruar që ndikimet mjedisore dhe sociale të vlerësohen, të përcaktohen kërkesat e praktikave të mira dhe të mbahen konsultime para vendimmarrjes. Masat mbrojtëse përfshijnë standardet që i referohen: Direktivave të Bashkimit Evropian për vlerësimin dhe rregullimin e ndikimeve mjedisore; Politikave të Bankës Botërore mbi Mjedisin dhe Zhvendosjen; si dhe obligimet tjera që dalin nga traktatet dhe Memorandumet e Mirëkuptimit në fuqi. Instrumentet për vlerësim: Në fazën e planifikimit – Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social (SESA); në fazën e vendimmarrjes për investimin: Vlerësimi Mjedisor (VM), Vlerësimi Social (VS), Plani Zhvillimor i Sibocit, planet e veprimit të zhvendosjes –konsultimet me palët e përfshira dhe publikun e gjerë lidhur me këto janë ende në vazhdim.

Synimet kyçe mjedisore janë: për termocentralet ekzistuese (Kosova A dhe B), PATEL-i do të dëshironte të shihte një zvogëlim të dukshëm të emetimeve për secilën; masat e rehabilitimit dhe përmirësimit të Ofruesve të Furnizimit të Energjisë si dhe përafrimi i TC Kosova B me direktivat evropiane. Stabilimentet e reja – termocentrali i ri dhe miniera e re e Sibocit do të duhet të ndërtohen dhe operohen në pajtim të plotë me standardet mjedisore dhe teknike evropiane, ndërsa çështjet e trashëgimisë mjedisore – janë duke u trajtuar nga Projekti i Pastrimit dhe Rikultivimit të Tokës – në deponinë e hirit të TC Kosova A – që është rikultivim i rreth 5 km² për shfrytëzimin e ardhshëm të tokës për bujqësi.

Folësi i dytë kryesor

Ilir Morina – Udhëheqësi i Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
Folësi theksoi që Ministria e Mjedisit po përballlet me probleme duke marrë parasysh që Kosova ka trashëguar një mjedis tejet të ndotur nga aktivitetet e mëhershme. Problemet theksohen edhe më shumë nga mungesa e një Plani Hapësinor të Kosovës, i cili merret drejtpërdrejt me termocentralin e ri me thëngjill Kosova C, si dhe rezervat ujore. Kosova aktualisht nuk ka sistem për kontrollimin e ajrit, derisa ekziston sistemi për monitorimin e ujërave sipërfaqësore, por jo për ato nëntokësore. Emetimet janë zvogëluar qysh prej vitit 2000, por ende Kosova A tejkalon gjithë kufijtë, pra duke paraqitur sfida është nëse duhet të mbyllet plotësisht dhe të mbetemi pa energji, apo të vazhdojmë të emetojmë ndotje.

Sfida e parë për Ministrinë e Mjedisit ka qenë hartimi i legjislacionit në pajtim me Acquis Communautaire. Deri në 85% të ligjeve janë të harmonizuara me legjislacionin evropian. Një sfida tjetër është edukimi i publikut mbi rolin e mbrojtjes mjedisore. Përfundimisht, z. Morina theksoi që bashkëpunimi ndërkufitar nuk është në nivelin e kënaqshëm, si dhe që fondet për një bashkëpunim të tillë nuk janë shfrytëzuar në mënyrën e duhur.

PETAR BERON DHE SABRI HAMITI





MAJA FILIPOVIĆ DHE XHELAL CANZIBA

Folësi i tretë kryesor

Luan Shllaku – Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqërinë e Hapur

Në shoqëritë demokratike sektori energjetik është gjithmonë në konflikt me sektorin mjedisor, sepse industria e energjisë është një prej ndotësve më të këqij. Në Kosovë, është plotësisht e kundërta, sepse edhe Ministria e Energjisë edhe ajo e Mjedisit udhëheqin të njëjtën fushatë për zhvillimin e sektorit energjetik. Folësi theksoi që për të krijuar politika të mira mjedisore dhe sociale, duhen marrë parasysh shumë dimensione të zhvillimit. Fakti që Kosova ka rreth 14 miliardë tonë rezerva linjiti dhe mijëra tonë sulfite nuk do të thotë automatikisht që ka perspektiva të pasura nëse nuk di t'i menaxhojë ato si duhet. z. Shllaku paraqiti disa ide për një plan zhvillimor që përfshin edhe mjedisin dhe energjinë, i cili do të merrte parasysh ajrin, ujin dhe dheun, si dhe shëndetin publik, strukturën demografike, larinë biologjike dhe tokën bujqësore.

Kosova nuk mund të krahasohet me vendet si Suedia apo Gjermania. Dendësia e popullsisë në Kosovë është tejet e madhe, duke vënë kështu

hapësirën si problem kryesor. Një kufizim tjetër është cilësia e dobët e rezervave të linjtit. Folësi nënvizoi kufizimet tjera zhvillimore siç janë Bruto-Prodhimi Vendor, i cili është vetëm 2.5 miliardë Euro gjithsej, apo pak më shumë se 1000 Euro për kokë banori.

Sa i përket të qenit eksportues të energjisë, z. Shllaku hodhi poshtë idenë, duke e quajtur përrallë, si dhe shpjegoi që rezervat e linjtit përfshijnë një të katërtën e sipërfaqes së Kosovës, duke nënkuptuar që eksploatimi i tyre do të kërkonte zgjerimin e veprimtarisë minerare në sipërfaqet që aktualisht janë të destinuara për bujqësi, e ndoshta edhe shkatërrimin e qyteteve dhe fshatrave. Folësi megjithatë theksoi që nuk është kundër ndërtimit të TC Kosova C. Skenari aktual i Qeverisë për një termocentral që furnizon 2,100 megavatë në orë nuk është mundësia më e mirë. Qeveria duhet të marrë parasysh kufizimin natyror dhe të përcaktojë se cili skenar i zhvillimit të sektorit energjetik është më i përshtatshmi për Kosovën.

Privatizimi është aspekt tjetër i problemit të Kosovës: Qeveria duhet të jetë shumë vigjilente në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis, sepse nëse ky nuk

bëhet dhe nuk parashikohet për rritjet e ardhshme të industrisë, investitorët e jashtëm nuk do të kufizohen për të, ndërsa si rezultat Kosova do të ketë probleme të llahtarshme. Folësi në mbyllje tha që ruajtja dhe mbrojtja e resurseve është rol i gjithë qeverisë, e jo i ministrive individuale.

Përgjegjësi i parë

Berat Luzha – Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi filloi duke theksuar që çështjet mjedisore janë edhe globale edhe rajonale, gjë që kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të afërt mes vendeve në trajtimin e problemeve të përbashkëta dhe identifikimin e interesave të përbashkët, si resurset ujore (lumenjtë dhe liqenet) si dhe parqet nacionale. Aktualisht, ekziston një iniciativë për krijimin e “Parkut Nacional të Paqes”, në trekëndëshin mes Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi, si dhe parkut nacional të “Sharrit” mes Kosovës dhe Maqedonisë.

Bashkëpunimi rajonal do të ishte me dobi për ndërtimin e TC Kosova C, sepse mendohet që ky termocentral do të siguronte energjinë elektrike dhe të zvogëlonte ndotjen në gjithë rajonin. Projekti i Kosovës C ka ngritur brengat në bazë të përvojës aktuale që Kosova ka me dy termocentralet ekzistuese dhe me ndotjen e pamasë që ato krijojnë me shkakimin e ndotësve në ujë, ajër dhe tokë. Kosova ka nevojë për më shumë energji, ndërsa njëkohësisht sektori i energjisë është sektori kryesor ekonomik në Kosovë, është gjithashtu edhe ndotësi më i madh, ndërsa 97% e gjithë energjisë në Kosovë prodhohet nga linjiti dhe vetëm rreth 3% nga uji.

Përgjegjësi i dytë

Petar Beron - Parlamenti i Bullgarisë

Përgjegjësi filloi duke thënë që ka qenë i vetmi në panel, që përfaqëson një vend të BE-së si dhe që procesi i kaluar nga vendi i tij në dhjetë muajt e fundit paraqet përparësi, por edhe vështirësi. Gjatë ditës së parë të konferencës rajonale u tha që gjitha vendet e pranishme do të bashkohen me BE-në një ditë, kështu që këto shtete duhet të shfrytëzojnë këtë kohë për të plotësuar kërkesat e BE-së. Kur të bëhet kandidat për hyrje në BE, vendi aspirues nuk do të ketë kohë të mjaftueshme; thjesht duhet të respektojë gjitha afatet e vëna nga BE-ja. Nëse ai dështon t'i arrijë ato afate, mund të humbë fondet e parashikuara për një gjë të tillë.

Z. Beron theksoi arrijtjet në plotësimin e kërkesave të BE-së në lidhje me kornizën ligjore dhe

implementimin e saj. Ai i paraqiti audiencës rastin e termocentralit bërthamor Kozloduj, i cili ka disa ngjashmëri me TC Kosova C. Kozloduji ishte furnizuesi më i madh i energjisë në rajon – në vitin 2006 ai eksportoi afërsisht shtatë miliardë megavatë, derisa këtë vit eksporti bullgar është ulur në një milionë megavatë. Termocentrali nuklear u mbyll për shkak të insistimit të disa vendeve të BE-së, edhe pse shumë ekspertë dhe komisione dëshmuuan që reaktorët e tij do të mund të funksiononin me siguri të plotë së paku deri më 2012. Sa i përket centraleve tjera bullgare, të cilat operojnë me thëngjill, ato duhet të ulin emetimet e tyre të CO2 në pajtim me direktivat e BE-së, përveç nëse nuk do të ketë nevojë të mbyllën, që do të thotë se Bullgaria do të kthehej në importues të energjisë.

Përfundimisht, z. Beron theksoi që është bërë shumë në promovimin dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e dëgjimit të zërit të OJQ-ve, duke dhënë shembullin e tij personal dhe mënyrën se si ai kishte arritur në Parlamentin Bullgar pasi kishte qenë anëtar i ‘Eko-Glastnost’, OJQ e madhe mjedisore, e cila kishte filluar aktivitetet e saj në vetë fillin e tranzicionit.

Diskutimi

Ndotja ndërkufitare

Pjesëmarrësit u pajtuan që rrymat ajrore dhe lumenjtë kontinentale nuk respektojnë kufijtë shtetërorë të përcaktuar nga politikanët dhe gjeneralët. Ato lëvizin kah i shtynë forcat fizike, ndërsa nëse mbajnë ngarkesa ndotësish ato udhëtojnë bashkë me to. Vijimisht, ekziston një kufi ndaj zbutjes së ndotjes që mund të arrihet nga shtetet e veçanta si të vetme. Për të trajtuar këtë problem, kërkohet qeverisje e fuqishme mjedisore. Megjithatë, ligjet dhe politikat që rregullojnë fushën e mbrojtjes mjedisore nuk dalin siç priten apo synohen, për shkak të mangësive në hartimin e tyre, problemeve në implementim dhe fuqizimit të dobët dhe institucioneve të dobëta juridike. Njëkohësisht, ekziston presioni mbi Kosovën për të qenë në pajtim me standardet ndërkombëtare/evropiane si dhe rrjedhimisht bashkëpunimi rajonal për trajtimin e rasteve të çështjeve mjedisore ndërkufitare, si termocentralet me thëngjill në Kosovë që ndotin ujërat e lumit Ibër, rrjedhimisht Danubin në Serbi; fabrikën e çimentos në Han të Elezit, që ndot ajrin në zonën kufitare të IRJ të Maqedonisë. Kështu, është në interesin e gjitha vendeve që të bashkërendojnë politikat mjedisore.

SEANCA IV: “Qeverisja Mjedisore”

Moderator: Blerim Vela, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësi kryesor: Gerrit Vonkeman, Universiteti i Utrehtit, Holandë

Folësi kryesor: Kerstin Tews, Këshilltar i politikave, Gjermani

Folësi kryesor: Mirjana Brnadić, Parlamenti i Kroacisë

Folësi kryesor: Jeton Bytyqi, Agjencioni Kosovar për Integrim në BE

Përgjegjësi: Sadudin Berisha, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi rajonal: Marian Dodovski, Parlamenti i Maqedonisë

Folësi i parë kryesor

Gerrit Vonkeman – Universiteti i Utrehtit, Holandë

Folësi filloi me argumentimin se zhvillimi dhe gjendja e tanishme e politikave mjedisore të Bashkësisë Evropiane mund të kuptohen vetëm brenda kontekstit të saj. Jo vetëm që janë të rëndësishme qëllimet dhe kompetencat e bashkëpunimit evropian, por gjithashtu edhe procesi dhe procedurat e vendimmarrjes, buxhetet, prioritetet, perceptimi i problemeve, presionet e jashtme, vullneti politik, etj. Në vitin 1957, gjashtë shtete perëndimore fqinje (Gjermania Perëndimore, Holanda, Belgjika, Luksemburgu, Franca dhe Italia) kishin krijuar (tre) “Komunitete Evropiane” për bashkëpunim ekonomik, të bazuara në dy Traktatet e Romës dhe në Traktatin e mëhershëm të Parisit. Përkundër organizatave ndërkombëtare, këto komunitete në veçanti ishin të strukturuar dhe të organizuara mirë dhe kishin fonde që nga fillimi.

Sa i përket mjedisit, që nga ajo kohë mund të ndahen zhvillimet në faza, për secilën fazë nga pesëmbëdhjetë vite. Në fazën e parë, përqendrimi kryesisht ishte bërë në Politikën e Përbashkëta Bujqësore (PPB). Nuk iu ishte kushtuar kujdes mjedisit, por kah fundi, është bërë e qartë që duhet të merret parasysh kjo. Edhe pse, më se 300 pjesë të legjislacionit për mjedisin ishin miratuar gjatë kësaj faze, ato ishin ballafaquar me një model jo koherent dhe zakonisht ishin të dobëta.

Në ndërkohë, z. Vonkeman kishte theksuar se mezi ishte avancuar një përparim drejt tregut të përbashkët brenda kufijve, më shumë për shkak të kërkesave unanime në të gjitha vendimet. Kështu, shtetet anëtare kishin vendosur që tregu i brendshëm duhet të kompletohet në afat prej pesë viteve dhe se traktatet duhet të miratoheshin për ta bërë një gjë të tillë të mundshme. Probleme serioze mjedisore- si të brendshme (ndër të tjera dëmtimi i pyjeve për shkak të acidifikimit), ashtu edhe globale

(zbrazja e shtresës së ozonit, ndryshimet klimatike dhe të tjera ishin paraqitur në raportin e Brundtlandit “E ardhmja jonë e përbashkët”)– gjithashtu ishte theksuar që mbrojtja e mjedisit duhet të jetë synim zyrtar i bashkëpunimit evropian. E tërë kjo ishte realizuar nëpërmjet një akti të vetëm evropian, që kishte prezantuar termin e Komunitetit Ekonomik. Faza e tretë kishte filluar menjëherë në vitin 1987, me një zgjerim të madh të aktiviteteve mjedisore. Ishte themeluar një organ i qëndrueshëm dhe ishin hartuar politikat dhe legjislacionet, ishin mundësuar fonde të konsiderueshme për t’i zbatuar ato, si dhe ishte krijuar Agjencioni Evropian për Mjedis, ndër të tjera për të monitoruar gjendjen e mjedisit evropian.

BLERIM VELA





IVAN VUČIĆ, MIRJANA BRNADIC DHE NIKOLA SOPČIĆ

Veç kësaj, nuk ishte marrë parasysh seriozisht mbrojtja natyrore. Në ndërkohë, globalizimi si i ekonomisë ashtu edhe i mjedisit ishin bërë të qarta dhe komuniteti kishte marrë udhëheqjen e zhvillimit të politikave mjedisore ndërkombëtare. Brenda Evropës, jo vetëm Austria, Finlanda, Suedia kishin aplikuar për anëtarësim, por edhe muri i Berlinit kishte rënë, që kishte treguar që është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje e veçantë shteteve të Evropës Qendrore si dhe ish Bashkimit Sovjetik.

Në vitin 1992, duke u bazuar në Traktatin e Mاستrihtit, ishte krijuar Bashkimi Evropian që kishte prezantuar politika të përbashkëta në fushën e politikave të sigurisë dhe çështjeve të drejtësisë dhe punëve të brendshme. Në traktatet e mëvonshme të Amsterdimit dhe Nices, ishin miratuar qëllimet themelore si dhe vendimmarrjet në disa fusha, përfshirë mjedisin, që ishin bazuar në pozicionin e barabartë të Këshillit dhe Parlamentit. Në pesë vitet e para të fazës së katërt, që nga viti 2002, ishin bashkuar edhe 12 shtete të reja anëtare, kryesisht nga Evropa Qendrore.

Disa tjera do të anëtarësoheshin gjatë pjesës së mbetur të kësaj faze. Në fund, folësi kryesor theksoi që duhet të kihen parasysh zhvillimet e përmendura më lartë kur të bisedohet për politikat mjedisore të BE-së, me procedurat e saja, institucionet, fondet dhe legjislacionin. Më tutje, duhet t'i kushtohet vëmendje disa aspekteve mjedisore të procesit të hyrjes në BE.

Folësi i dytë kryesor

Kerstin Tews – Këshilltar për politika, Gjermani

Folësi kryesor filloi, duke theksuar që në themelimin e Procesit për Stabilizim dhe Asociim në vitin 1999, Bashkimi Evropian (BE) iu kishte ofruar shteteve të Evropës Jug-Lindore (EJL) perspektivën e anëtarësimit në afatin e mesëm dhe atë të gjatë. Pasi secili shtet kërkonte të bëhej anëtar, shtetet nga rajoni i EJL duhet që plotësisht t'i përmbahen rregullave të BE-së.

Gjersa, kriteret politike dhe ekonomike pasqyronin parimet fundamentale të demokracisë dhe ekonomisë së tregut si parime udhëzuese të integritimit evropian, kriteri i tretë është më shumë se sa kornizë për një rregullim të dëshirueshëm shoqëror. E drejta e bashkimit evropian përmban akte ligjore në disa fusha të politikave, duke përfshirë ato të mjedisit të zhvilluara me dekada, që janë të obligueshme për shtetet anëtare dhe për ato shtete që dëshirojnë të bëhen anëtare para hyrjes në BE.

Z. Tews shtoi se, deklarata e Komisionit e vitit 1998 që kishte të bënte me zgjerimin e strategjive për mjedis në lidhje me Evropën Qendrore dhe Lindore theksonte që përmbushja e kërkesave të mjedisit nuk është synim përfundimtar, as për shtetet candidate, e as për Bashkimin Evropian. Sfidat e integritit të plotë të dimensioneve zhvillimore të qëndrueshme të mjedisit në fushat kryesore mbetet sfida kryesore dhe urgjente për tërë Bashkimin Ev-



MARIAN DODOVSKI

ropian. Procesi i zgjerimit duhet të shikohet në këtë perspektivë të gjerë dhe duhet të menaxhohet në atë mënyrë që të sjell objektivin e zhvillimit vërtetë të qëndrueshëm sa më afër vendit.

Përmbushja e rregullave ekzistuese të kërkesave mjedisore- të cilat gjithnjë janë rezultat i kompromisit ndërmjet udhëheqësve të mjedisit dhe atyre që janë të prapambetur në BE, është minimumi që BE-ja duhet të kërkojë në mënyrë që të sigurohet që kapaciteti i BE-së për të zhvilluar më tutje politikë zhvillimore pas zgjerimit. E drejta mjedisore është vetëm njëra pjesë e tërë së drejtës, por pasi është zhvilluar që nga vitet e 70-ta përmban akte të shumta ligjore- më shumë se 200 akte legjislative pasqyrojnë zhvillimin e politikave sa i përket çështjeve mjedisore në BE.

Për shtetet e EJT obligimi për ta përmbushur kriterin mjedisor për hyrje në BE ofron një rast për të zhvilluar rrethana shoqërore të shtetit në tranzicion, ku pa mundësinë e anëtarësimit, çështjet mjedisore vështirë që do të hynin në agjendat politike. Çështjet tjera siç janë ristrukturimi ekonomik, varfëria sociale, konsolidimi politik dhe- në rastin e këtij rajoni- trashëgimi i konfliktit do ta zhvendosë çështjen mjedisore nga agjenda.

Andaj, nga kjo perspektivë kushtëzimi dhe agjenda e jashtme e përpiluar sa i përket të drejtave

mjedisore ofrojnë rast për t'i mos i harruar të drejtat mjedisore dhe për t'i krijuar kapacitetet e domosdoshme institucionale, ligjore dhe njerëzore. Megjithatë, folësi e përfundoi fjalimin duke thënë që ky proces i agjendës së jashtme sa i përket politikave mjedisore gjithashtu përfshinë edhe disa çështje kritike jo vetëm për rajon, por edhe për kapacitetet e BE-së, që gjithashtu t'i zhvillojë më tutje politikë mjedisore.

Folësi i tretë kryesor

Mirjana Brnadić – Parlamenti i Kroacisë

Folësja e tretë kryesore hapi fjalimin e saj, duke theksuar që mbrojtja e mjedisit është duke iu nënshtruar reformës së qëndrueshme në Kroaci për ta mbrojtur, mirëmbajtur dhe promovuar gjendjen e mjedisit dhe natyrës në përputhje me standardet e BE-së, si parakusht për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik.

Negociatat e Kroacisë me BE-në për hyrje në BE kishin filluar më 3 tetor 2005; mbrojtja e mjedisit është njëri prej 35 kapitujve të së drejtës së BE. Në prill të vitit 2006, ishte mbajtur një takim për projekt multilateral për kapitullin 27, që ka të bëjë me mjedisin, ku Komisioni Evropian kishte shpjeguar në hollësi pjesën e së drejtës që ka të bëjë me mjedisin. Në maj të vitit 2006, ishte mbajtur një takim tjetër i përbashkët ku përfaqësuesit kroat kishin prezantuar shkallën e zhvendosjes dhe zbatimit të së drejtës mjedisore.

Znj. Brnadić kishte njoftuar që në raport theksohet që Kroacia kishte mbërritur në një nivel të kënaqshëm të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, por ende duhet bërë për të rritur kapacitetet administrative në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal. Vlerësimi i Komisionit Evropian ishte që në përgjithësi ishte arritur një përparim i mirë sipas kapitullit për mbrojtjen e mjedisit, posaçërisht në mbrojtjen e ujërave dhe ajrit, mbrojtjes së natyrës, mbrojtjes kimike dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht. Sidoqoftë, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë dhe shtrirjen e këtij kapitulli, duhet të bëhen shumë përpjekje të mëtejme.

Legjislacioni i BE-së për mbrojtjen e mjedisit përmban më shumë se 200 akte kryesore që përmbajnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ajrit dhe ujërave, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rrezikut, mbrojtjen kimike dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht, të zhurmave dhe pylltarisë. Kroacia, në fund të vitit 2008, në tërësi do

ta inkorporoj legjislacionin e BE-së për mbrojtjen mjedisore në legjislacionin vendor.

Folësja kryesore theksoi që mund të pritët që bisedat për kapitullin e mjedisit mund të zgjasin shumë dhe do të përfundojnë vetëm atëherë kur të gjithë tjerët, që kanë ndikim në mjedis siç është ndikimi në politikat për bujqësi, tregti, energjetikë ose industri, të jenë të përmbushura. Veç kësaj, për shkak të investimeve të shumta që janë dashur të bëhen për mbrojtjen e mjedisit, që do të jetë e pamundur që të mbulohen gjatë disa viteve në vijim, Kroacia do të tentojë të bëjë zgjedhje të brendshme për secilën fushë të këtij kapitulli.

Folësi i katërt kryesor

Jeton Bytyqi – Agjencioni Kosovar për Integritet

Folësi filloi duke shpjeguar që Kosova nuk ka marrëdhënie kontraktuese me BE-në. Sidoqoftë, Perspektiva Evropiane për Ballkanin Perëndimor gjithashtu është e hapur për Kosovën. Kjo pasqyrohet në miratimin e Partneritetit Evropian të publikuar në qershor të vitit 2004 dhe në vitin 2006. Është duke u mbajtur dialogu ndërmjet Kosovës dhe BE-së nëpërmjet Mekanizmit Përcjellës të Asocimit Stabilizimit Evropian (MPASE). Korniza e MPAS, e cila është miratuar në mënyrë unike për Kosovën- pasi që ende nuk është shtet- siguron që Kosova mundet plotësisht të merr pjesë në Procesin e Asociimit dhe Stabilizimit (PAS). Takimet e MPAS-it janë dialogje teknike të nivelit të lartë ndërmjet Komisioneve Evropiane dhe Institucioneve Kosovare.

Përafrimi i legjislacionit me të drejtat mjedisore të BE-së është njëri ndër kushtet për anëtarësim në BE për secilin shtet, i cili dëshiron t'i bashkohet BE-së. Në këtë kontekst, Kosova është duke treguar përparim të madh pasi që miraton legjislacionin e saj në linjë me të drejtat mjedisore të BE-së. Kosova ka krijuar institucione që janë përgjegjëse për përparim, edhe ka vënë në funksion procedurat ligjore. Koordinimi i përafrimit të legjislacionit është përgjegjësi e Drejtorisë për Legjislacion brenda AEI. Çdo projekt ligj, para se të shkojë në takimin e qeverisë për miratim, së pari parashtrohet në AIE për t'u bërë korigjimi për përputhshmëri me BE-në. Folësi përmendi, që Kosova ende nuk ka Plan Kombëtar të Veprimit për përafrim të legjislacionit.

Mbrojtja e mjedisit është një lëmi e ndjeshme për BE-në. Shtetet anëtare të BE-së e kanë kuptuar që mbrojtja e mjedisit nuk mund të arrihet vetëm nga

një shtet anëtar, ndotja e ajrit nuk ndalet në kufij. Andaj, mirëmbajtja e niveleve të ndryshme të mbrojtjes në shtetet anëtare do të çrregullonte tregun e brendshëm, posaçërisht konkurrencën. Kështu, sipas traktatit të KE, ishin prezantuar Politikat e Komunitetit për Mjedis me një qëllim që të kontribuojnë: mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, masat promovuese në nivelin ndërkombëtar për t'u marrë me problemin mjedisor rajonal ose mbarë botëror.

Më tutje, neni 95 i Traktatit të Komunitetit Evropian (TEK) në përafrim të ligjeve në BE thekson që Komisioni, në propozimet e tija për përafrim të ligjeve, rregullore ose dispozitave administrative të shteteve anëtare që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë, mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke marrë si bazë nivelin e lartë të mbrojtjes, duke marrë parasysh në veçanti çdo zhvillim të ri të bazuar në fakte shkencore. Duke u bazuar në këto baza ligjore, Komuniteti ka ndërmarr masa të rëndësishme ligjore. Janë miratuar disa rregullore dhe urdhëresa përkatëse.

Këto masa kanë përmirësuar mbrojtjen e mjedisit në BE. Më tutje, Komuniteti ka kontribuar në mbrojtjen e mjedisit në nivelin global duke përfshirë dispozita lidhur me mjedisin në marrëveshjet tregtare. Shumica e marrëveshjeve për tregti që janë arritur me shtetet në zhvillim i përmbajnë këto dispozita. Sa i përket Kosovës, siç është rasti me shtetet në zhvillim, ajo ballafaqohet me sfidat e zhvillimit ekonomik, në njërin anë, edhe mbrojtjen e mjedisit, në tjetrën anë. Sidoqoftë, ligjet mjedisore gjithashtu i nënshtrohen procedurave të kontrollimit të përputhshmërisë së BE-së. Që nga themelimi i Zyrës për Proceset e Integritet Evropian, tani AEI, janë kontrolluar më shumë se dhjetë (10) projekt ligje që kanë të bëjnë me mjedisin. Duhet të theksohet që disa nga këto projektligje kanë marrë dritën e gjelbër për hapin e ardhshëm të procedurës legjislative (takimi i Qeverisë për miratim) vetëm pas ndryshimeve të domosdoshme që janë bërë që nga atëherë, fillimisht disa nga këto projektligje kanë shkelur parimet kryesore të Legjislacionit të BE-së mbi mjedisin.

Edhe pse ligjet e miratuara në përputhje me legjislacionin e BE-së janë hap i mirë përpara, folësi kishte theksuar që në kornizën e tanishme ligjore që ka të bëjë me mjedisin në Kosovë është larg përmbushjes së standardeve të BE-së për mbrojtjen mjedisore. Folësi pranon, që zbatimi i tërësishëm i Normave të BE-së për Mbrojtje Mjedisore do të

kishte ndikim negativ në ekonominë e Kosovës. Kosova është duke shkuar ngadalë, por me kujdes drejt miratimit të ligjeve dhe është duke u përpjekur që mos të rrezikojë as zhvillimin ekonomik, e as përafrimin e ligjeve të saja me Ligjin e BE-së.

Përgjegjësi i parë

Sadudin Berisha- Kuvendi i Kosovës
Folësi theksoi, që Kuvendi i Kosovës është zotuar për zhvillim ekonomik, duke zbatuar politika të mirëfillta sociale, duke u përpjekur të ndal papunësinë e madhe, dhe duke ofruar kujdes shëndetësor për të gjithë qytetarët. Kuvendi dhe Komisioni Mjedisor, veçanërisht janë zotuar për mjedis duke u bazuar në besimin që zhvillimi ekonomik, jo vetëm në Kosovë, por edhe në shtetet përreth, pak është shoqëruar me legjislacion të mirëfilltë mjedisor dhe si pasojë mjedisi është shumë i ndotur dhe do të duhet të bëhen shumë investime për tu kthyer në gjendjen e mëparshme.

Z. Berisha theksoi që folësi paraprak e përmendi legjislacionin e miratuar nga BE-ja që tregon se jo vetëm që shtetet në rajon janë duke bërë përpjekjet e tyre për t'u integruar në këtë fushë, por edhe vetë BE-ja është duke u përballur me sfidat e reja mjedisore për shkak të zhvillimit të jashtëzakonshëm ekonomik.

Legjislacioni i miratuar nga Kuvendi i Kosovës është i rëndësishëm por nuk është i mjaftueshëm; pasi që nuk është duke u zbatuar. Këto vështirësi të paraqitura brenda Ekzekutivit, në organet dhe strukturat e ndryshme që merren me mjedisin, me çështjet mjedisore, industriale, tregtare, transportit,

telekomunikacionit, bujqësisë, përplasen me njëra tjetrën në tentimet e tyre për t'i realizuar programet e tyre.

Përgjegjësi i dytë

Marian Dodovski – Parlamenti i Maqedonisë

Folësi kryesor theksoi, që sa i përket hyrjes së Maqedonisë në BE si dhe nënshkrimit të stabilizim-asociimit në vitin 2005; raporti i parë për mjedisin ishte paraqitur në vitin 2005 dhe Maqedonia e ka fituar statusin e kandidatit.

Sa i përket harmonizimit të legjislacionit me kërkesat e BE-së, Maqedonia ka filluar të punoj në vitin 1997 dhe ka filluar me programet e përafrimit dhe programet kombëtare sa i përket mjedisit me rritjen e kapaciteteve nacionale. Folësi theksoi, që Maqedonia nuk ka pasur Ministri të Mjedisit gjatë vitit 1997.

Programet më të reja të PHARE dhe CARDS kishin përfshirë projektet për përafrim të legjislacionit si dhe për hartimin e legjislacionit të ri– ligjin për mjedisin, ligjin për cilësinë e ajrit, ligjin për natyrën dhe ligjin për mbrojtjen nga ndotja dhe ligjin për mbeturina. Folësi theksoi, që Maqedonia ka ratifikuar një numër të konsiderueshëm të traktateve, veçanërisht ato për ndryshimet klimatike, që janë në përputhje të plotë me standardet evropiane. Sa i përket “ndërmarrjes së veprimeve”, secili shtet duhet të fillojë me fondet e veta dhe të mos pres për fonde; fonde shtesë do të jepen pasi të jenë iniciuar veprimet me mjete vetanake financiare. Kroacia është shembull i mirë për këtë.

Lista e pjesëmarrësve

**KONFERENCA RAJONALE
PARLAMENTARE PËR
MJEDISIN**
19-20 TETOR 2007 –
PRISHTINË/PRIŠTINA

PARLAMENTI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. Katerina Dimevska
2. Marian Dodovski
3. Hazbije Ibishi
4. Ajshe Selmani
5. Jasminka Perčinkova

PARLAMENTI KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË BULLGARISË

1. Evdokia Maneva
2. Petar Beron
3. Rumen Takorov
4. Stancho Todorov
5. Ognian Georgiev

PARLAMENT I FEDERATËS SË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS

1. Slavica Josipović
2. Sanda Redžić
3. Amra Muzur

PARLAMENTI KROAT

1. Mirjana Brnadić
2. Nikola Sopčić
3. Ivan Vučić
4. Maja Filipović

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Ilir Bano
2. Idriz Xhomara

FOLËSIT:

1. **Markku Laamanen**,
Zëvendësi i shefit të Misionit të
OSBE-së në Kosovë
2. **Lodewijk Vanoost**,
Misioni i OSBE-së në Kosovë
3. **Blerim Vela**,
Misioni i OSBE-së në Kosovë
4. **Peter Vanhoutte**,
Misioni i OSBE-së në Kosovë
5. **Franklin DeVrieze**,
Misioni i OSBE-së në Kosovë
6. **Andrew Farmer**,
Instituti për Politikat Mjedisore
Evropiane
7. **Marianna Bolshakova**,
Komisioni Ekonomik i Kombeve
të Bashkuara për Evropën
8. **David Swalley**,
Aktivitetet Ekonomike dhe
Mjedisore të OSBE-së
9. **Gerrit Vonkeman**,
Universiteti i Utrehtit
10. **Kerstin Tews**,
Këshilltar për politika
11. **Merxhan Avdyli**,
Zëvendës Ministër i Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
12. **Lorik Haxhiu**,
Ministria e Energjetikës dhe
Minierave
13. **Ilir Morina**,
Kryesuesi i Agjencionit Kosovar
për Mbrojtje të Mjedisit
14. **Jeton Bytyqi**,
Agjencioni Kosovar për
Integrime në BE
15. **Zeqir Veselaj**,
Qendra Rajonale për Mjedis
16. **Luan Shllaku**,
Fondacioni Kosovar për Shoqëri
të Hapur


PJESËMARRËSIT NGA KUVENDI I KOSOVËS:

1. **Sabri Hamiti**
2. **Rifat Krasniç**
3. **Lulzim Zeneli**
4. **Jusuf Sutaj**
5. **Shaban Halimi**
6. **Qibrije Hoxha**
7. **Fetah Berisha**
8. **Berat Luzha**
9. **Afrim Arzullaxhiu**
10. **Xhelal Canziba**
11. **Sadudin Berisha**
12. **Selvije Halimi**
13. **Bajram Badivuku**

PJESËMARRËSIT TJERË:

1. **Muhamet Malësiu**,
Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
2. **Muhamet Aliu**,
Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
3. **Ismajl Hetemaj**,
Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
4. **Scott Sinclair**,
Zyra e Bankës Botërore në
Kosovë
5. **Edon Vrenezi**,
Zyra e Bankës Botërore në
Kosovë
6. **Tush Markaj**,
ekspert kosovar për mjedis





MJEDISI SI MEDIUM PËR PROMOVIMIN E DEMOKRACISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHOQËRIVE NË TRANZICION

Agjenda e hollësishme për
pjesëmarrësit e Konferencës
Rajonale Parlamentare
për Mjedisin

18 – 21 tetor, 2007
Prishtinë

Mjedisi si medium për promovimin e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik të shoqërive në tranzicion

18 – 21 tetor, 2007, Prishtinë

Dita e parë: e enjte, 18 tetor 2007

12:00 – 17:00 **Ardhja e delegacioneve nga Parlamentet dhe Kuvendet e Evropës Jug-Lindore**
Vendi: Receptioni i Hotelit 'Grand'- kati përdhes

18:00 **Pritja në Kuvendin e Kosovës**
Fjalime të shkurta nga Sabri Hamiti– Zëvendës Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
Ambasadori Markku Laamanen– Zëvendësi Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë
Vendi: Kuvendi i Kosovës

19:00 **Darkë mirëseardhjeje e shtruar nga Kuvendi i Kosovës**

Dita e dytë: e premte, 19 tetor 2007

08:30 **Regjistrimi i pjesëmarrësve**
Vendi: Hoteli 'Grand' Salla e konferencave- kati i parë

09:00 **Fjalimet mirëseardhëse**
Sabri Hamiti– Zëvendës Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Lulzim Zeneli– Zëvendës Udhëheqësi i Komisionit të Kuvendit për Mjedis dhe Markku Laamanen – Zëvendës Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë
Vendi: Hoteli 'Grand' Salla e konferencave- kati i parë

09:40 **Pushim për kafe**
Vendi: Hoteli 'Grand' – kati i parë

10:00 **Seanca për qeverisjen e mjedisit**
Moderator: Lulzim Zeneli, Kuvendi i Kosovës
Folësi kryesor: Andrew Farmer, Instituti për Politikat Mjedisore Evropiane
Folësi kryesor: Merxhan Avdyli, Zëvendës Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Folësi kryesor: Lodewijk Vanoost, Misioni i OSBE-së në Kosovë
Përgjegjësi i KK: Shaban Halimi, Kuvendi i Kosovës
Përgjegjësi rajonal: Sanda Redžić, Anëtare e Komitetit Parlamentar për Mjedis i Parlamentit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës
Vendi: Hoteli 'Grand' Salla e konferencave- kati i parë

12:30 **Dreka**
Vendi: Restoranti i Hotelit 'Grand'– kati përdhes

14:00 **Seancë mbi parimet e konventës së Aarhus-it– qasja në informata, në vendimmarrje dhe drejtësi, praktikë nga Evropa dhe rajoni**
Moderator: Fetah Berisha, Kuvendi i Kosovës
Folësi kryesor: Marianna Bolshakova, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
Folësi kryesor: David Swalley, Aktivitetet Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së
Folësi kryesor: Zeqir Veselaj, Qendra Rajonale për Mjedis
Përgjegjësi nga KK: Jusuf Sutaj, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi rajonal: Idriz Xhomara, Anëtar i Komisionit Parlamentar për Tregti dhe Mjedis i Kuvendit të Shqipërisë
Vendi: Hoteli 'Grand' Salla e Konferencave- kati i parë

17:00

Vërejtjet përmbyllëse

Vendi: Hoteli 'Grand' Salla për konferenca- kati i parë

17:30

Koktejt me OJQ-të vendore për Mjedis

Vendi: Hoteli 'Grand' – kati i parë

Dita e tretë: E shtunë, 20 tetor 2007

09:00

Seancë mbi bashkëpunimin përtej kufijve për çështjet mjedisore: Sektor i Energjetikës

Moderator: Peter Vanhoutte, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësi kryesor: Lorik Haxhiu, Ministria e Energjetikës dhe Minierave

Folësi kryesor: Ilir Morina, Kryesuesi i Agjencionit Kosovar për Mbrojtje të Mjedisit

Folësi kryesor: Luan Shllaku, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur

Përgjegjësi nga KK: Berat Luzha, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi rajonal: Petar Beron, Anëtar i Komitetit Parlamentar për Mjedis dhe Ujëra i Parlamentit të Bullgarisë

Vendi: Hoteli 'Grand' Salla për konferenca- kati i parë

12:00

Dreka

Vendi: Restaurant i Hotelit 'Grand' – kati përdhes

14:00

Korniza Ligjore e BE-së për mjedis dhe praktikat më të mira nga rajoni

Moderator: Blerim Vela, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Folësi kryesor: Gerrit Vonkeman, Universiteti i Utrehtit

Folësi kryesor: Kerstin Tews, Këshilltar për politika

Folësi kryesor: Mirjana Brnadić, Anëtare e Komisionit për Mbrojtje të Planifikimit Hapësinor dhe për Mjedis të Parlamentit të Kroacisë

Folësi kryesor: Jeton Bytyqi, Agjencioni Kosovar për Integritet në BE

Përgjegjësi nga KK: Sadudin Berisha, Kuvendi i Kosovës

Përgjegjësi rajonal: Marian Dodovski, Anëtar i Komisionit për Transport, Lidhje dhe Ekologji i Parlamentit të Maqedonisë

Vendi: Hoteli 'Grand' Salla për konferenca- kati i parë

17:00

Mbyllja e konferencës

Vendi: Hoteli 'Grand' Salla për konferenca- kati i parë

17:30

Koktejt


Vendi: Hoteli 'Grand' – kati i parë

Dita e katërt: E diel, 21 tetor 2007


09:00 – 12:00

Nisja e delegacioneve nga Parlamentet e Evropës Jug-Lindore





Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë punon për **stabilitetin, prosperitetin dhe demokracinë** në 56 shtete nëpërmjet dialogut politik rreth vlerave të përbashkëta dhe punës praktike e cila rezulton në krijimin e një dallimi të qëndrueshëm.

 Seksioni për Kuvendin dhe Partitë Politike
Departamenti i Përkrahjes
Misioni i OSBE-së në Kosovë